FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 5

Tiranë – E hënë, 13 janar 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 9.1.2025	Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore dhe përcaktimin e kritereve e të procedurave për dhënien e shpërblimeve për punonjësit e Policisë së Shtetit.....	423
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 9.1.2025	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtim muri rrethues për godinën e re të SPAK-ut"	434
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 9.1.2025	Për disa ndryshime në vendimin nr. 11, datë 11.1.2024, të Këshillit të Ministrave "Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin e NATO-s, '*Aegean Sea*', në detin Egje"	437
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 7, datë 9.1.2025	Për emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Vlorës.....	437
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 9.1.2025	Për përcaktimin e standardeve të planit të sigurisë e të elementeve të mbrojtjes për sipërfaqen për kultivim dhe përpunim të bimës së *cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe rregullave të lëvizjes së automjeteve të dedikuara të transportit të lëndëve të para dhe produkteve që duhet të plotësojnë subjektet e licencuara.....	437
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 9, datë 9.1.2025	Për përcaktimin e rregullave dhe të tarifave për ruajtjen dhe sigurinë fizike për subjektet e lejuara.....	442
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 11, datë 9.1.2025	Për lirimin nga detyra të drejtorit të përgjithshëm të Teatrit Kombëtar.....	445
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 14, datë 9.1.2025	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 55, datë 6.2.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti"	445

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 15, datë 9.1.2025	Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2025.....	447
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 9.1.2025	Për planin vjetor të pranimit për vitin 2025, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil.....	452
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 181, datë 6.8.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 193, datë 6.10.2022, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre"	453
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1141, datë 31.12.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Ukrainës.....	471
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1151, datë 31.12.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	474
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1152, datë 31.12.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Greqisë.....	476
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1153, datë 31.12.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së aftës epizootike të shfaqur në shtetin e Turqisë.....	478
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1154, datë 31.12.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe të dhive të shfaqur në shtetin e Turqisë.....	479
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 1, datë 6.1.2025	Për delegimin e kompetencave.....	481
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Arkivave nr. 2, datë 6.1.2025	Për delegimin e kompetencave.....	481
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 2, datë 6.1.2025	Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë të egër, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla.....	482
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 4, datë 7.1.2025	Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla.....	483
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 276, datë 13.12.2024	Mbi licencimin e shoqërisë "M.C Energji Gojan" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Gojan".....	484
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 277, datë 13.12.2024	Mbi shtyrjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria "Albgaz" sh.a.....	486
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 56, datë 8.1.2025	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Eliminimi i pikave të zeza *(Black Spots)* në rrjetin rrugor kombëtar Shkodër–Hani i Hotit, kryqëzimi Rruga e Hurmave".....	488

VENDIM
Nr. 4, datë 9.1.2025

PËR MIRATIMIN E VLERAVE PËR SECILIN ELEMENT PËRBËRËS TË PAGËS BRUTO MUJORE DHE PËRCAKTIMIN E KRITEREVE E TË PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E SHPËRBLIMEVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të ndryshuar, dhe të pikave 2, shkronjat "a" e "d", dhe 4, të nenit 104, të ligjit nr. 82/2024, "Për Policinë e Shtetit", me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka për qëllim:

a) miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të Policisë së Shtetit sipas strukturave në të cilat ushtrojnë funksionet policore;

b) miratimin e trajtimit financiar të:

i. kursantëve që pranohen në kolegjin profesional "Kolegji i Policisë";

ii. punonjësve të policisë të rolit zbatues dhe shtetasve që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, që pranohen të vazhdojnë programet e studimit në Akademinë e Sigurisë me kohë të plotë dhe studentëve që caktohen për të ndjekur studimet me kohë të plotë në akademitë e policisë së shteteve partnere, sipas marrëveshjeve të përbashkëta;

iii. punonjësve të Policisë së Shtetit që kryejnë kurse shkollimi/trajnimi;

iv. punonjësve të Policisë së Shtetit që bashkëpunojnë me institucionet arsimore të sistemit policor, si punonjës të jashtëm;

c) përcaktimin e kritereve e të procedurave për dhënien e shpërblimeve për rezultate të larta në kryerjen e detyrës.

2. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore dhe vlerat për secilin element për punonjësit e Policisë së Shtetit janë, si më poshtë vijon:

a) Paga për gradë, që përfaqëson nivelin e pagës së punonjësit të policisë, në përputhje me gradën që ka fituar. Vlera e pagës për gradë përcaktohet në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Shtesa për natyrë të veçantë pune e lidhur me natyrën e veçantë të punës apo të shërbimit, për kohën që punonjësit e policisë ushtrojnë detyrat funksionale (sipas funksioneve/pozicioneve të miratuara në organikë) dhe që përcaktohet:

i. në lidhjen nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për punonjësit e policisë që punojnë në strukturat e luftës kundër krimit të organizuar, krimeve të rënda, antiterrorit dhe në strukturat e policisë shkencore;

ii. në lidhjen nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për punonjësit e policisë që punojnë në strukturat e ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike;

iii. në lidhjen nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për punonjësit e policisë që punojnë në strukturat e policisë kufitare dhe migracionit;

iv. në lidhjen nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për punonjësit e policisë që punojnë në strukturat e tjera policore;

v. në lidhjen nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për punonjësit e policisë që punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, diplomë universitare të nivelit "Master i Shkencave", "Master Profesional", "Bachelor" apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët "Inxhinieri elektronike", "Inxhinieri informatike", "Informatikë", "Inxhinieri telekomunikacioni", "Teknologji informacioni", "Informatikë ekonomike" "Informatikë biznesi", "Inxhinieri matematike informatike", "Shkenca kompjuterike" apo "Inxhinieri matematike (në analiza sistemesh)";

c) Shtesa për natyrë të veçantë pune, që lidhet me kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, që aplikohet në rastet kur punonjësit e policisë punojnë në vende pune të vështira e të dëmshme për shëndetin. Masa e kësaj shtese përcaktohet në lidhjen nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

ç) Shtesa për funksionet organike për punonjësit e rolit zbatues përcaktohet në lidhjen nr. 8, që i

bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

d) Shtesa për vjetërsi në shërbim që është shtesa që përfiton punonjësi i policisë me grada për kohën e qëndrimit në grada aplikohet në masën 1% për çdo vit deri në 25 (njëzet e pesë) vjet. Llogaritja e shtesës për vjetërsi bëhet mbi pagën për gradë të nivelit më të ulët të gradës sipas ndarjes në role.

3. Përjashtimisht, deri në datën 1 janar 2026, shtesa për vjetërsi në shërbim sipas shkronjës "d", të pikës 2, të këtij vendimi, llogaritet mbi pagën e gradës "inspektor".

4. Për efekt të llogaritjes së shtesës për vjetërsi në shërbim, vite shërbimi do të konsiderohen vitet e qëndrimit në grada, të dokumentuara në librezën e punës apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, të çdo punonjësi në strukturat e Policisë së Shtetit, Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Policisë së Burgjeve, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, Gardës së Republikës së Shqipërisë, Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, si dhe në strukturat e Shërbimit Informativ të Shtetit.

5. Vitet që përjashtohen nga llogaritja e shtesës së vjetërsisë në shërbim, vetëm për efekt page, janë vitet e sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, vitet e punës si punonjës pa gradë, vitet e shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit ushtarak të Ministrisë së Brendshme e të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe periudhat e trajtimit me pagesë papunësie apo pagesë kalimtare.

6. Kursantët që pranohen në Kolegjin Profesional të Formimit Policor, në Akademinë e Sigurisë, gjatë periudhës së shkollimit përfitojnë trajtim financiar, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

7. Punonjësit e policisë të rolit zbatues dhe shtetasit, që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, që pranohen dhe vazhdojnë programet e studimit në Akademinë e Sigurisë me kohë të plotë, për ciklin e parë të studimeve "Bachelor", si dhe studentët që caktohen për të ndjekur studimet me kohë të plotë në akademitë e policisë të shteteve partnere sipas marrëveshjeve të përbashkëta, gjatë periudhës së shkollimit përfitojnë çdo muaj një bursë shkollimi të barabartë me pagën për gradën "inspektor".

Këtë trajtim e përfitojnë edhe shtetasit që pranohen në Akademinë e Sigurisë të cilët kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në dispozitat përkatëse në ligjin për Policinë e Shtetit.

8. Punonjësi i policisë, që shkollohet/trajnohet, brenda ose jashtë vendit, në kuadër të programeve të shkollimit/trajnimit, të parashikuara e të organizuara nga institucioni gjatë periudhës së shkollimit/trajnimit, përfiton të njëjtën pagë bruto mujore, që përfitonte përpara fillimit të kursit të shkollimit/trajnimit. Pagesa e punonjësit të Policisë kryhet nga njësia buxhetore, ku është efektiv punonjësi, përpara fillimit të kursit të shkollimit/trajnimit.

9. Në rastet kur punonjësi i policisë ka fituar një kurs shkollimi apo trajnimi në mënyrë individuale dhe jo me iniciativën e institucionit, gjatë kohës së shkollimit/trajnimit nuk përfiton pagesë nga institucioni.

10. Punonjësi i policisë, që nuk është efektiv me kohë të plotë në institucionet e sistemit arsimor policor, por bashkëpunon me këto institucione si punonjës i jashtëm, për çdo orë mësimore 60-minutëshe, përfiton një pagesë, si më poshtë vijon:

a) Në kurset e formimit bazë për punonjësit me gradë "Inspektor", në masën 600 (gjashtëqind) lekë/për orë;

b) Në kurset e shkollimit/trajnimit për punonjësit e gradave "Nënkomisar" dhe "Komisar", në masën 800 (tetëqind) lekë/për orë;

c) Në kurset e shkollimit/trajnimit për punonjësit e gradave "Kryekomisar" deri në "Drejtues i Parë", në masën 1000 (një mijë) lekë/për orë.

11. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit shpërblen punonjësit e Policisë së Shtetit për rezultate të larta në kryerjen e detyrës, në përputhje me kriteret e përcaktuara për këtë qëllim. Masa e këtij shpërblimi është deri në 3 (tre) paga mujore në vit.

12. Kriteret për përfitimin e shpërblimit për rezultate të larta në kryerjen e detyrës janë:

a) kryerja e operacioneve të sigurisë së veçantë dhe zgjidhja e situatave të jashtëzakonshme për rendin dhe sigurinë publike;

b) parandalimi i ngjarjeve të rënda kriminale, si: vrasje, akte terroriste, rrëmbim ose mbajtje peng të

personit apo shkatërrimit të pronës me pasoja të rënda;

c) kryerja e operacioneve për kapjen e personave në kërkim me rrezikshmëri të lartë apo autorëve të armatosur të veprave penale pas kryerjes së krimit (në kushtet e flagrancës);

ç) zbulimi, hetimi dhe arrestimi/ndalimi i autorëve të ngjarjeve të rënda kriminale, që kanë impakt në publik;

d) kryerja e operacioneve policore të rëndësishme për hetimin dhe arrestimin/ndalimin e autorëve, që kanë kryer apo kapen në kryerje e sipër të veprave penale të krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave dhe krimit ekonomik;

dh) zbulimi, hetimi dhe arrestimi/ndalimi i grupeve të strukturuara kriminale dhe organizatave kriminale;

e) kryerja e operacioneve të ndërhyrjes për shpëtimin e jetës së njerëzve, në kushtet e emergjencave civile;

ë) kontributi i punonjësit të policisë në rritjen e standardeve të punës në fushën e rendit dhe sigurisë publike, dhe në fusha të tjera të veprimtarisë policore, duke arritur rezultate të larta dhe të dallueshme në kryerjen e detyrës në raport me punonjësit e tjerë të strukturës policore, periudhat paraardhëse, objektivat strategjikë dhe programet vjetore të Policisë së Shtetit.

13. Titullarët e njësive shpenzuese, drejtorët e drejtorive qendrore, drejtuesit e departamenteve dhe zëvendësdrejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, bazuar në rezultatet e larta të arritura në kryerjen e detyrave, sipas kritereve të përcaktuara në pikën 12, të këtij vendimi, i propozojnë drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit shpërblimin e punonjësve, shoqëruar për çdo rast me një relacion shpjegues.

14. Masa e shpërblimit jepet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

15. Të gjithë punonjësit e rolit zbatues, që kanë pasur gradën "Inspektor i parë" dhe "Inspektor i dytë", të cilët, për shkak të ligjit nr. 82/2024, "Për Policinë e Shtetit", marrin gradën "Inspektor", deri në datën 1 janar 2026, do të vijojnë të përfitojnë vlerën e pagës për gradë dhe të shtesave për natyrë të veçantë pune, sipas gradës dhe shtesave që kanë pasur deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

16. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për programin "Policia e Shtetit" dhe fillojnë:

a) për përcaktimet në shkronjat "ç" dhe "d", të pikës 2, në pikën 6 dhe në pikën 10, të këtij vendimi, nga data 1 janar 2026;

b) për të gjitha parashikimet e tjera të këtij vendimi, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

17. Vendimi nr. 416, datë 26.6.2024, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e vlerave për secilën element përbërës të pagës bruto mujore dhe të trajtimeve të tjera financiare për punonjësit e Policisë së Shtetit", shfuqizohet, me përjashtim të përcaktimeve në pikat 5 dhe 9, që vijojnë të jenë në fuqi deri në datën 31.12.2025.

18. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

Paga për gradë për punonjësit e policisë

Roli i punonjësve sipas gradave	Grada	Paga mujore për gradë
Për punonjësit e rolit madhor	Drejtues madhor	180,000
	Drejtues i lartë	160,000
Për punonjësit e rolit të mesëm drejtues	Drejtues i parë	135,000
	Drejtues	120,000
Për punonjësit e rolit të parë drejtues	Kryekomisar	105,000
	Komisar	95,000
	Nënkomisar	85,000
Për punonjësit e rolit zbatues	Inspektor	70,000

Lidhja nr. 2

Grada	Shtesa për natyrë të veçantë pune apo shërbimi për punonjësit e policisë që punojnë në strukturat e luftës kundër krimit të organizuar, krimeve të rënda, antiterrorit dhe në strukturat e policisë shkencore					
	Në funksione të: - Drejtorisë të Forcës së Posaçme Operacionale; - Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë; - Njësisë Operacionale për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe B.D; - Të Sektorit të Forcës së Posaçme të Operacioneve Speciale dhe Kërkimit në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë.	Në funksione të: - Sektorit të Hetimit nën Mbulim në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale.	Në funksionet të: - Drejtorisë së Antiterrorit; - Për hetimin e krimeve të rënda në strukturat qendrore e vendore të Policisë së Shtetit.	Në funksione të: - Sektorit të Zbatimit të Masave Mbrojtëse; - Sektori i Ndihmës Ligjore dhe Integrimit në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.	Në funksione të: - Inteligjencës dhe Arkivës Kriminale në Drejtoritë Vendore të Policisë; - Instituti i Policisë Shkencore.	Në funksione: - Për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve; - Për Hetimin e Krimit Ekonomik e Financiar; - Për Hetimin e Krimit të Organizuar; - Të Inteligjencës dhe Arkivës Kriminale në Departamentin e Policisë Kriminale (DPK); - Të Njësisë për mbështetjen Hetimore Ndërkombëtare në DPK; - Të Njësisë për Trajtimin e Informacionit të Klasifikuar në DPK; - Në funksione të Sektorit të Monitorimit Administrativ; - Të Njësisë së Informacionit të Pasagjerit (NIP) në DPK; - Të Policisë Shkencore në strukturat vendore të Policisë së Shtetit; - Për Hetimin e Krimeve Kibernetike në strukturat qendrore e vendore të Policisë së Shtetit; - Për përgjimet Ambientale dhe për mbështetjen operacionale të hetimit në DVP; - Sektorit për Përgjimet e Telekomunikacionit në Departamentin e Policisë Kriminale.
Inspektor	15,500	25,000	11,000	15,000	7,000	9,000
Nënkomisar	15,500	25,000	11,000	15,000	7,000	9,000
Komisar	15,500	25,000	11,000	15,000	7,000	9,000
Kryekomisar	15,500	25,000	11,000	15,000	7,000	9,000
Drejtues	15,500	25,000	11,000	15,000	7,000	9,000
Drejtues i parë	15,500	25,000	11,000	15,000	7,000	9,000

Lidhja nr. 3

Grada	Shtesa për natyrë të veçantë pune apo shërbimi për punonjësit e policisë që punojnë në strukturat e ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike					
	Në funksione të: - Njësisë speciale "RENEA" (Shef Njësie, zv./ Shef Njësie); - Në strukturat operacionale të Njësisë Speciale "RENEA"; - Njësisë speciale të negocimit; - Njësisë speciale antieksploziv.	Në funksionet: - Në strukturat e Njësisë Speciale të Mbrojtjes së Veçantë NJSMV; (Shef njësie, zv. shef njësie, Seksioni operacional për mbrojtjen e personave me cilësi të veçantë); - E seksionit të patrullës së përgjithshme dhe F.P Shqiponja; - Të Forcës së Posaçme "Shqiponja"/ "Shigjeta".	Në funksionet: - Për krimet në volum në strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit; - Drejtorisë së Forcave Kombëtare të Sigurisë; - Zv./drejtor në drejtoritë vendore të policisë; - Shef i Komisariatit të policisë; - Shef stacioni dhe specialist.	Në funksionet: - Për Rendin Publik në strukturat qendrore e vendore të Policisë së Shtetit; - Policisë Rrugore në strukturat qendrore e vendore të Policisë së Shtetit; - Menaxhimit dhe drejtimit në strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit; - Analizës strategjike, planifikimit, monitorimit dhe vlerësimit; - Analizës së riskut, analizës strategjike, planifikimit monitorimit dhe vlerësimit; - Patrullës së përgjithshme dhe sigurisë; - Të sigurisë dhe shoqërimit, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit; - Të rendit publik, në sallat e komandimit, të drejtimit në sektorin/ seksionin e komandës dhe kontrollit; - Ndihmës specialist informacioni, përgjegjës turni, specialist turni dhe informacioni; - Sigurimit të objekteve në strukturat vendore; - Informacionit ruajtjes dhe sigurimit të objekteve; - Njësisë së Sigurisë dhe Ceremonialit.	Në funksione: - Të Policimit në komunitet në strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit (shef sektori e seksioni, specialist i policimit në komunitet, specialist, Ndihmës specialist për edukimin në shkolla dhe punën me të rinjtë); - Ndihmës specialist/ SPZ; - Specialist/koordinator për SPZ; - Ndihmës specialist, përgjegjës për dhomat e sigurisë dhe trup shërbimi për ruajtjen e dhomave të sigurisë; - Shef Poste policie; - Shef Stacioni policie.	Në funksione të: - Njësive të Sigurisë Publike , (shef njësie dhe strukturat operacionale).
Inspektor	40,000	15,500	9,000	6,000	7,000	11,000
Nënkomisar	40,000	15,500	9,000	6,000	7,000	11,000
Komisar	40,000	15,500	9,000	6,000	7,000	11,000
Kryekomisar	40,000	15,500	9,000	6,000	7,000	11,000
Drejtues	40,000	15,500	9,000	6,000	7,000	11,000
Drejtues i parë	40,000	15,500	9,000	6,000	7,000	11,000

Lidhja nr. 4

Grada	Shtesa për natyrë të veçantë pune apo shërbimi për punonjësit e policisë që punojnë në strukturat e policisë kufitare dhe migracionit				
	Në funksione: - Shef njësie në Njësinë Speciale për Kufirin dhe Migracionin "Delta"; - Të shërbimeve operacionale tokësore e detare, të Njësisë Speciale për Kufirin dhe Migracionin "Delta".	Në funksione: - Të kufirit dhe zbatimit të masave plotësuese të kontrollit të territorit në DVKM Tiranë; - Të hetimit të masave plotësuese për kontrollin e territorit; - Të hetimit dhe zbatimit të masave plotësuese për kontrollin e territorit.	Në funksione: - Drejtor i Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin; - Drejtor i Qendrës së Mbyllur; - Shef Komisariati për Kufirin dhe Migracionin.	Në funksione: - Të kufirit; - Të migracionit; - Të Analizës së Riskut dhe Statistikës në strukturat qendrore dhe vendore të policisë; - Në seksionin e pritjes trajtimi dhe sigurisë në QMH; - Stacionet e Policisë Kufitare; - Postat e Policisë Kufitare; - Të sallave të komandës dhe drejtimit; - Të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare; - Të qendrave të shkëmbimit të informacionit; - Të seksionit të sigurisë kufitare.	Në funksione: - Të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë.
Inspektor	15,000	7,000		6,000	6,000
Nënkomisar	15,000	7,000		6,000	6,000
Komisar	15,000	7,000	9,000	6,000	6,000
Kryekomisar	15,000	7,000	9,000	6,000	6,000
Drejtues	15,000	7,000	9,000	6,000	6,000
Drejtues i parë		7,000	9,000		

Lidhja nr. 5

	Shtesa për natyrë të veçantë pune apo shërbimi për punonjësit e policisë që punojnë në strukturat e tjera policore						
Grada	Në funksione të: - Drejtorisë së Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave; - Drejtorisë së Standardeve Profesionale; - Shef sektori në Aparatin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Departamentet e Policisë; - Trupë shërbimi/Dajt DTI; - Drejtorisë së Integrimit dhe Planifikimit Strategjik; - Drejtorisë së Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor; - Në funksione të Akademisë së Sigurisë.	Në funksione: - Mbështetëse dhe administrative të sektorëve dhe seksioneve të strukturave qendrore, vendore dhe strukturave të veçanta të policisë.	Në funksione: - Drejtor drejtorie në varësi të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe të drejtorit të departamentit; - Drejtori i Kabinetit të DPPSH.	Në funksione: - Asistent i zv./drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit; - Asistent i drejtorit të departamentit; - Asistent në Drejtorinë Vendore të Policisë; - Zëdhënës në Drejtorinë Vendore të Policisë.	Në funksione: - Shef sektori për komunikimin me median dhe publikun, në Drejtorinë për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median; - Të drejtorive në varësi të Departamentit për Marrëdhëniet Ndërkombëtare.	Në funksione: - Të drejtorit të drejtorisë vendore të Policisë; - Të kabinetit të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit (zyra ndihmëse); - Shefit të Sektorit të Auditimit.	Në funksione të: - Drejtorit të drejtorisë vendore të Policisë Tiranë; - Drejtorit të departamentit; - Zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit; - Rektorit të Akademisë së Sigurisë; - Drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
Inspektor	6,000	4,000		7,000	9,000		
Nënkomisar	6,000	4,000		7,000	9,000		
Komisar	6,000	4,000		7,000	9,000		
Kryekomisar	6,000	4,000	15,500	7,000	9,000		
Drejtues	6,000		15,500	7,000	9,000	15,000	
Drejtues i parë	6,000		15,500		9,000	15,000	30,000
Drejtues i lartë							30,000
Drejtues madhor							40,000

Lidhja nr.6

Shtesa për natyrë të veçantë pune apo shërbimi për punonjësit e policisë që punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit

1. "Specialistët", "Përgjegjësit e sektorit", "Drejtorët e drejtorive" apo "drejtor departamenti", të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, diplomë universitare të nivelit "Master i Shkencave/Master Profesional/Bachelor" apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët "Inxhinieri Elektronike", "Inxhinieri Informatike", "Informatikë", "Inxhinieri Telekomunikacioni", "Teknologji Informacioni", "Informatikë Ekonomike" "Informatikë Biznesi", "Inxhinieri Matematike Informatike", "Shkenca Kompjuterike", "Inxhinieri Matematike (në analiza sistemesh)" përfitojnë një shtesë mbi pagë si vijon:

a) Për punonjësit e policisë që punojnë me baza të të dhënave shtetërore, (si punonjësit analogë civilë pa status policor) në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në nivel qendror, në masën:

60,000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë në muaj	Për punonjësit e policisë në pozicionet "Specialist".
50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj	Për punonjësit e policisë në pozicionet "Përgjegjës sektori".
70,000 (shtatëdhjetë mijë) lekë në muaj	Për punonjësit e policisë në pozicionet "Drejtor drejtorie" apo "drejtor departamenti".

b) Për punonjësit e policisë në strukturat e TIK-ut në nivel qendror, që punojnë në pozicione IT, që nuk janë përgjegjëse për zhvillimin apo ndjekjen e mirëmbajtjes së bazave së të dhënave shtetërore të miratuara e të regjistruara si të tilla pranë Autoritetit Rregullator Koordinues të Bazave të të Dhënave Shtetërore, sipas legjislacionit në fuqi (si punonjësit analogë civilë pa status policor) në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në masën 7 500 (shtatë mijë e pesëqind) lekë në muaj.

2. Zbatimi i shtesave si më sipër për pozicionet konkrete të punës miratohet:

a) Nga titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për punonjësit e policisë të përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 1, të kësaj lidhjeje, pas propozimit nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas përshkrimit të pozicionit të punës;

b) Nga Departamenti i Administratës Publike, për punonjësit e policisë të përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 1, të kësaj lidhjeje, sipas përshkrimit të pozicionit të punës.

Lidhja nr. 7

Masa e shtesës për natyrë të veçantë pune për shkak të kushteve të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas funksioneve organike

Nr.	Emërtimi i funksionit	Emërtimi i strukturës policore	Masa e shtesës në lekë
I	**Në strukturat e Policisë Shkencore**	**Në Institutin e Policisë Shkencore**	
1	Drejtor; Shef sektori; Specialist kriminalist; Ndihmës specialist, laborant kriminalist; Inspektor/ekspert; Inspektor; Ekspert.	- Në Institutin e Policisë Shkencore; - Në sektorin e përpunimit të gjurmëve papilare dhe vendit ngjarjes; - Në sektorin e ekzaminimeve, biologjisë dhe ADN-së; - Në sektorin e ekzaminimeve kimike; - Në sektorin e ekzaminimeve balistike.	12,000
2	Shef sektori; Specialist; Specialist kriminalist; Ndihmës specialist; Laborant kriminalist; Specialist i administrimit të provave;	- Në sektorin e kontrollit shkencor të cilësisë; - Në sektorin e gjurmëve të gishtave (daktiloskopia); - Në sektorin e ekzaminimeve grafike dhe dokumenteve; - Në sektorin e administrimit të provave dhe dokumentacionit.	10,600

	Laborant i administrimit të provave.		
3	Shef sektori; Specialist kriminalist; Inspektor; Ekspert.	- Në sektorin e ekzaminimeve kompjuterike dhe audio-video.	5,300
4	Shef sektori; Shef seksioni; Specialist; Ndihmës specialist laborant; Laborant; Specialist ekspert.	**Në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë**: - Në sektorin e policisë shkencore; - Në seksionin për vendngjarjet dhe ekzaminimet; - Në sektorin e kartotekës e administrimit të provave. **Në komisariatet e Policisë Tiranë:** - Në seksionin për krimet. **Në drejtoritë vendore të Policisë:** - Në sektorin e policisë shkencore. **Në komisariatet e Policisë:** - Në seksionin e policisë shkencore; - Në seksionin për krimet; - Në seksionin për krimet e rënda dhe për krimet.	10,600
II		**Në strukturat e trajtimit dhe magazinimit të lëndëve narkotike**	
1	Specialist për trajtimin e lëndëve narkotike. Ndihmës specialist për magazinën e narkotikeve.	- Në Drejtorinë e Përgjithshme për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda; - Në sektorin për hetimin e narkotikëve.	10,600
III		**Në strukturat e përgjimit**	
1	Shef sektori; Specialist; Oficer i policisë gjyqësore përgjimi SHISH; Oficer i policisë gjyqësore zyra e Prokurorit të Përgjithshëm; Ndihmës specialist për përgjimin ambiental operacional; Ndihmës specialist depërtimi dhe kamuflimi; Ndihmës specialist për hetimin; Ndihmës specialist përgjimi në operacione speciale.	- Në sektorin e përgjimit e telekomunikimit; - Në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale: - Në sektorin e hetimit nën mbulim dhe funksionet në sektorin e mbështetjes tekniko- shkencore; - Në qendrën e drejtimit dhe menaxhimit të operacioneve speciale.	5,300
2	Shef seksioni; Specialist për përgjimin dhe depërtimi;. Ndihmës specialist.	**Në drejtoritë vendore të Policisë Tiranë:** - Në seksionin tekniko-shkencor dhe depërtimin.	5,300
3	Shef seksioni; Specialist; Ndihmës specialist; Specialist për teknologjinë dhe përgjimin; Ndihmës specialist për teknologjinë dhe përgjimin.	**Në drejtoritë vendore të Policisë:** - Në seksionin e teknologjisë dhe përgjimit; - Në Komisariatet e Policisë.	5,300
IV		**Në strukturat e trajtimit të eksplozivëve dhe lëndëve të tjera plasëse:**	
1	Shef njësie; Specialist antieksplozivësh në forcat speciale; Ndihmës specialist, në forcat speciale; Shoqërues qeni dhe shofer.	- Në Njësinë Speciale të Antieksplozivëve.	9,300
V		**Zhytësit dhe punonjësit e shërbimeve operacionale detare:**	
1	Komandant njësie; Zëvendëskomandant njësie; Trupë shërbimi operacional/zhytës; Trupë shërbimi operacional/zhytës dhe shofer; Shef seksioni; Specialist për shërbimet e kufirit blu; Përgjegjës grupi, drejtues mjeti lundrues; Trupë shërbimi, motorist; Trupë shërbimi operator.	- Në njësinë speciale të zhytjes; - Në shërbimet operacionale detare	1,500
VI	**Në strukturat e policisë rrugore:**		
1	Shef njësie;	**Në njësinë operacionale për sigurinë rrugore dhe sigurinë e autostradave.** **Në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë**:	5,300

	Specialist; Trupë shërbimi Ndihmës specialist; Specialist për policinë rrugore, koordinator; Shef seksioni; Specialist shërbimi, përgjegjës; Përgjegjës trupë shërbimi. Ndihmës specialist; Oficer i policisë gjyqësore; Specialist; Ekspert.	- Në Komisariatin e Policisë Rrugore Tiranë dhe në seksionin e trafikut interurban dhe urban, në strukturat organike të Policisë së Shtetit; - Në Komisariatin Rajonal të Policisë Rrugore; - Në seksionin e parandalimit dhe sigurisë në trafikun urban; - Në seksionin e parandalimit dhe sigurisë në linja jashtë qytetit; - Në seksionin e verifikimit të shkeljeve administrative dhe analizës; - Në seksionin e hetimit të aksidenteve rrugore (OPGJ); - Në seksionin e verifikimit të aksidenteve rrugore (ekspertët/dëme materiale).	
2	Shef sektori; Shef seksioni; Specialist i hetimit të ngjarjeve në qarkullim; Specialist shërbimi, përgjegjës grupi; Përgjegjës grupi; Trupë shërbimi; Trupë shërbimi trafiku dhe linja në të gjitha strukturat e policisë rrugore.	**Në drejtoritë vendore të Policisë:** - Në sektorin e policisë rrugore; - Në seksionin e hetimit të ngjarjeve në qarkullim dhe AIS. **Në komisariatet e Policisë:** - Në seksionin e kontrollit dhe menaxhimit të qarkullimin rrugor.	5,300
VII	**Mjekë dhe ndihmës mjekë**	**Në strukturat e Policisë së Shtetit:**	
1	Shef seksioni; Mjek; Trupë operacionale; Ndihmësmjek; Trupe shërbimi operacional shofer ambulance; Specialist mjek; Ndihmës mjek trupë operacionale.	- Në repartin special "RENEA"; - Në Njësitë e Ndërhyrjes së Shpejtë.	4,000

Lidhja nr. 8

Shtesa për funksionet organike për punonjësit e rolit zbatues

Funksioni organik	Vlera
Në strukturat e vendore: - Ndihmës specialist për informacionin; - Ndihmës specialist përgjegjës për dhomat e sigurisë; - Ndihmës specialist për komandën dhe koordinimin; - Ndihmës specialist për policimin në komunitet, SPZ; - Ndihmës specialist, Seksioni për shërbimin ndaj të tretëve; - Ndihmës specialist për komandën dhe koordinimin; - Ndihmës specialist SPZ; - Ndihmës specialist për zbatimin e vendimeve penale dhe kontrollin e armëve; - Ndihmës specialist për edukimin në shkolla dhe punën me të rinjtë; - Ndihmës specialist operator, për shërbimin ndaj të tretëve; - Ndihmës specialist i komandës dhe kontrollit. **Në strukturat e DVKM-së:** - Ndihmës specialist për analizën e riskut e statistikën; - Komandant Skuadre; - Ndihmës specialist, Seksioni i Hetimit dhe Zbatimit të Masave Plotësuese për Kontrollin e Territorit; - Ndihmës specialist informacioni, në Komisariatin e Policisë Kufitare Sarandë; - Përgjegjës grupi, drejtues mjeti lundrues; - Ndihmës specialist, intervis, për riintegrimin, ripranimin/kontrollor; - Ndihmës specialist, Qendra e Shkëmbimit të Informacionit me Greqinë;	10 000 (dhjetëmijë) lekë

- Ndihmës specialist, Qendra e Shkëmbimit të Informacionit me Kosovën; - Ndihmës specialist, Qendra e Shkëmbimit të Informacionit me Maqedoninë. **Në strukturat qendrore:** - Ndihmës specialist hetimi, Sektori për Përgjimet e Telekomunikacionit; - Ndihmës specialist për arkivimin, Njësia për Trajtimin të Informacionit të klasifikuar; - Ndihmës specialist, Njësia për Administrimin e Provave Materiale; - Ndihmës specialist, turni dhe informacioni, në Njësinë e Sigurisë dhe Ceremonialit; - Ndihmës specialist për përgatitjen, në Institutin e Përgatitjes së Qenve të Policisë; - Ndihmës specialist , në DFPO; - Ndihmës specialist për përgjimin ambiental operacional, në DFPO; - Ndihmës specialist depërtimi dhe kamuflimi, në DFPO; - Përgjegjës grupi, drejtues mjeti lundrues, Njësia Speciale për Kufirin "DELTA".	
Funksioni Organik	Vlera
Në strukturat vendore: - Ndihmës specialist për analizën dhe statistikën; - Ndihmës specialist, Seksioni i arkivit kriminal; - Ndihmës specialist për arkivin kriminal; - Ndihmës specialist, Seksioni i informacionit policor; - Ndihmës specialist për informacionin policor dhe statistikën; - Ndihmës specialist për informacionin policor dhe arkivin kriminale; - Ndihmës specialist për operacionet policore; - Ndihmës specialist për marrjen/analizimin e pamjeve filmike; - Ndihmës specialist për kërkimin; - Ndihmës specialist, Seksioni për mbështetjen tekniko shkencore dhe depërtimin; - Ndihmës specialist laborant, Seksioni i kartotekës dhe administrimit të provave; - Ndihmës specialist për sigurinë, Seksioni i patrullës së përgjithshme dhe sigurisë; - Ndihmës specialist për sigurinë dhe informacionin; - Trupë shërbimi për ruajtjen e dhomave të sigurisë; - Ndihmës specialist për shoqërimin dhe sigurinë; - Ndihmës specialist për administrimin e dokumenteve; - Ndihmës specialist, kujdestar ai dhe komandant nëngrupi; - Ndihmës specialist laborant për Policinë Shkencore; - Laborant për Policinë Shkencore, Seksioni i hetimit të aksidenteve Rrugore (Shërbimi i policisë gjyqësore), Komisariati i Policisë Rrugore Tiranë; - Ndihmës specialist, Seksioni i Sallës së Komandimit, Komisariati i Policisë Rrugore Tiranë; - Ndihmës specialist për Krimet; - Ndihmës specialist, ruajtje dhe sigurim i objekteve; - Ndihmës specialist, Seksioni i vendit të ngjarjes dhe ekzaminimeve; - Ndihmës specialist, Seksioni i Kartotekës dhe Administrimit të Provave; - Ndihmës specialist, Seksioni për Hetimin e Krimeve Kibernetike; - Ndihmës specialist përgjimi; - Ndihmës specialist, Seksioni për Mbështetjen Operacionale të Hetimit; - Ndihmës specialist, Seksioni i Administrimit të Dokumentove dhe AIS; - Ndihmës specialist sigurim objekti dhe informacioni; - Trup shërbimi operacionale (F.P) Shqiponja/ Motorist, në DVP Fier; - Ndihmës specialist, Seksioni i Monitorimit dhe Koordinimit kundër Kultivimit;	5 000 (pesëmijë) lekë 5 000 (pesëmijë) lekë

- Ndihmës specialist, Seksioni për Hetimin e Narkotikëve; - Ndihmës specialist për Inteligjencën dhe Statistikën; - Ndihmës specialist, Seksioni për Hetimin e Krimeve të Rënda; - Ndihmës specialist, Seksioni i Policisë Shkencore; - Ndihmës specialist (F.P.); - Ndihmës specialist, Seksioni për kontrollin e kontejnerëve; - Ndihmës specialist, Seksioni Për Hetimin e Krimeve ndaj personit. **Ne strukturat e DVKM:** - Ndihmës specialist i kartotekës dhe arkivit; - Ndihmës specialist, kontrollor; - Ndihmës specialist informacioni, në DVKM Tiranë; - Përgjegjës grupi operacional; - Trupë shërbimi operacional; - Ndihmës specialist, Seksioni për të huajt; - Ndihmës specialist operator për migracionin; - Ndihmës specialist, kontrollor laborant kriminalist; - Ndihmës specialist i vijës së dytë ai dhe kontrollor; - Ndihmës specialist/operator për Sistemin dhe Kamerat/Trup Shërbimi, Kontrollor; - Trupë shërbimi, operator radari. **Ne strukturat qendrore:** - Ndihmës specialist operator; - Ndihmës specialist, Sektori i Analizës së Informacionit; - Ndihmës specialist/statistikën, Sektori i Analizës Riskut dhe Statistikës, në DPKM; - Ndihmës specialist; - Ndihmës specialist operator (24/7 Europol & Interpol); - Ndihmës specialist për arkivin; - Trupë shërbimi, ruajtje objekti, si komand. skuadre, në Njësinë e Sigurisë dhe Ceremonialit; - Trupë shërbimi ceremoniali si Komandant skuadre, në Njësinë e Sigurisë dhe Ceremonialit; - Ndihmës specialist, operator për kamerat, në Qendrën e Mbyllur të të Huajve.	

VENDIM
Nr. 5, datë 9.1.2025

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIM MURI RRETHUES PËR GODINËN E RE TË SPAK-ut"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtim muri rrethues për godinën e re të SPAK-ut".

2. Shpronësimi bëhet në favor të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për

pasuritë e llojit "truall", me një vlerë të përgjithshme prej 650 698.80 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë tetëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 650 698.80 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë tetëdhjetë) lekësh, përballohet nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

8. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë për Prokurorinë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë për Prokurorinë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILËT SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "NDËRTIM MURI RRETHUES PËR GODINËN E RE TË SPAK-ut"

NR. RENDOR	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)									TË DHËNAT PËR SHPRONËSIM				SHËNIME (Kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
													TRUALL			VLERA TOTALE (lekë)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Truall (m^2)	Ndërtesë (m^2)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)		
1	ATEA	FEJZI	MALAJ	TIRANË	8330	8/436	TRUALL	111	111	0	36	142	6.80	34,068.00	231,662.40	231,662.40	Shënim. Seksioni D "Urdhër/vendim për vendosje sekuestro konservative", me nr. regjistrimi 20116, datë 28.8.2022, afat 99 vjet. Zyra e Përmbarimit Privat "ASTREA".
2	REZARTA	AZMI	TELA	TIRANË	8330	8/469	TRUALL	151	151	0	49	246	12.30	34,068.00	419,036.40	419,036.40	
VLERA TOTALE															650,698.80	**650,698.80**	

VENDIM
Nr. 6, datë 9.1.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 11, DATË 11.1.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN E NATO-s, "*AEGEAN SEA*", NË DETIN EGJE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të shkronjës "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 11, datë 11.1.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin e NATO-s, "*Aegean Sea*", në detin Egje", bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, togfjalëshi "... 22 (njëzet e dy) ushtarakë ..." zëvendësohet me "... 23 (njëzet e tre) ushtarakë ...";

b) Në pikën 4, fjalia "Kohëzgjatja e këtij misioni është 1 (një) vit nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi." zëvendësohet me "Kohëzgjatja e këtij misioni është deri më 31.12.2028.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 7, datë 9.1.2025

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË VLORËS

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Plator Nesturi emërohet prefekt i Qarkut të Vlorës.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 8, datë 9.1.2025

PËR PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE TË PLANIT TË SIGURISË E TË ELEMENTEVE TË MBROJTJES PËR SIPËRFAQEN PËR KULTIVIM DHE PËRPUNIM TË BIMËS SË *CANNABIS-it* PËR QËLLIME MJEKËSORE DHE RREGULLAVE TË LËVIZJES SË AUTOMJETEVE TË DEDIKUARA TË TRANSPORTIT TË LËNDËVE TË PARA DHE PRODUKTEVE QË DUHET TË PLOTËSOJNË SUBJEKTET E LICENCUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave "d" dhe "e", të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 61/2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale", me propozimin e ministrit të Brendshëm, të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton standardet e planit të sigurisë dhe elementeve të mbrojtjes për sipërfaqen për kultivim dhe përpunim të bimës së *cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe rregullat e lëvizjes së automjeteve të dedikuara të transportit të lëndëve të para e të produkteve, që duhet të plotësojnë subjektet e licencuara.

2. Ky vendim ka për qëllim miratimin e rregullave për personat juridikë që paraqesin kërkesë për licencë për prodhimin e *cannabis*-it mjekësor, sipas përcaktimeve të shkronjave "d" dhe "e", të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 61/2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale".

3. Në kuptim të këtij vendimi me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

a) "Ambient i hapur" është ambienti i kultivimit në natyrë pa shtresa mbrojtjeje apo mbuluese.

b) "Ambient i mbrojtur" është një mjedis i kontrolluar dhe i mbuluar, i cili krijon kushte të favorshme për rritjen e bimëve, duke i mbrojtur ato nga ndikimet atmosferike të jashtme, si ndryshimet ekstreme të temperaturës: era apo reshjet e shiut. Ky ambient lejon depërtimin e rrezatimit diellor dhe zakonisht përfshin struktura, si serra ose tunele plastike, që ofrojnë një shkallë të caktuar kontrolli mbi temperaturën, lagështinë dhe dritën.

c) "Ambient i mbyllur" është një mjedis plotësisht i kontrolluar, i mbuluar dhe i izoluar nga ndikimet e jashtme atmosferike, i cili ofron kushte të favorshme për rritjen e bimëve pa depërtimin e rrezatimit natyror diellor. Ky lloj ambienti përdor ndriçim artificial dhe sisteme të kontrolluara për parametrat, si: drita, lagështia, temperatura, ventilimi dhe për ndikimin e faktorëve të tjerë të jashtëm, duke siguruar kushte optimale për kultivimin.

ç) "Subjekt i ngarkuar për ruajtjen dhe sigurinë fizike" është SHPSF-ja e pajisur me licencë të nënkategorive 1.3.A. dhe 1.3.B ose *"Illyrian Guard",* sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin privat të sigurisë fizike.

II. STANDARDET E PLANIT TË SIGURISË PËR SIPËRFAQEN PËR KULTIVIMIN DHE PËRPUNIMIN E *CANNABIS*-it DHE ELEMENTET E MBROJTJES, RRETHIMIT, SIGURISË ME TELEKAMERA DHE SIGURIMIT FIZIK PËR 24 ORË, ELEMENTET PENGUESE PËRPARA HYRJES DHE TEL ME GJEMBA MBI GARDHIN

1. Subjekti i licencuar në ambientet ku ushtrohet aktiviteti duhet të plotësojë standardet e mëposhtme:

a) Ambientet duhet të jenë të monitoruara në vazhdimësi me sistem të kamerave CCTV, i pajisur me *reader* të inkorporuar dhe sensorë lëvizjeje, me rezolucion të lartë, prej të paktën 1280 x 720, me rreze infra të kuqe, përfshirë hapësirën 20 metra jashtë rrethimit, e cila duhet të jetë e ndriçuar. Imazhet filmike të sistemit të kamerave duhet të ruhen të paktën për 90 ditë në NRV/server dhe të paktën për një periudhë 1-vjeçare në memorie *Cloud*, me vendndodhje në një nga vendet e BE-së;

b) Sistemi i kamerave CCTV monitoron sipërfaqen, brenda dhe jashtë ambienteve të njësisë së prodhimit, duke u orientuar në mënyrë që të sigurohet identifikim i qartë dhe i sigurt i ambienteve dhe i të gjithë individëve që aksesojnë apo lëvizin brenda tyre apo në ambientet e jashtme pranë rrethimit;

c) Përdorimi i pajisjeve elektronike të teknologjisë së lartë, në funksion të sigurisë (detektorë, ura kontrolli);

ç) Në varësi të vlerësimit të rrezikut dhe në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit, lidhja e sinjalit të alarmit, në nivel qendror dhe / ose vendor, me sallat e komandimit/ informacionit të Policisë së Shtetit;

d) Sipërfaqja ku ushtrohet aktiviteti ruhet 24 orë pa ndërprerje nga subjekti i ngarkuar për ruajtjen dhe sigurinë fizike që përfshin dhe shërbim reagimi me grup verifikimi sinjalesh;

dh) Për rastet kur kultivimi kryhet në ambiente të hapura ose të mbrojtura rrethohet nga jashtë me mur betoni të qëndrueshëm me trashësi të paktën 25 (njëzet e pesë) cm dhe lartësi 4 m nga toka, mbi të cilin vendoset tel me gjemba;

e) Për rastet kur kultivimi kryhet në ambiente të mbyllura, muri i jashtëm i godinës duhet të jetë mur betoni i qëndrueshëm me trashësi të paktën 25 cm;

ë) Hyrja në ambientet e njësisë është e kufizuar dhe mundësohet përmes një porte hekuri që garanton aksesin vetëm për personat dhe mjetet e autorizuara, si dhe monitorohet nga sistemi i kamerave CCTV, të përcaktuara në shkronjën "a" të kësaj pike;

f) Porta e hyrjes kontrollohet nga personel i autorizuar për sigurinë, i cili mban evidencë për çdo hyrje-dalje të personave, automjeteve dhe mallrave;

g) Materialet teknike, të cilat garantojnë sigurinë dhe monitorimin, vendosen në një dhomë të veçantë të dedikuar brenda perimetrit të sipërfaqes ku ushtrohet aktiviteti, në të cilën ka akses vetëm personeli përgjegjës për sigurinë.

2. Subjekti i licencuar paraqet vetëdeklarim për gatishmërinë për të lidhur marrëveshje me strukturën përgjegjëse të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike për të garantuar aksesin për inspektim ndaj shoqërisë private të sigurisë fizike, sipas formatit të vetëdeklarimit të përcaktuar në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Mbajtësi i licencës duhet të ketë dhe të ndjekë procedura për të ruajtur dhe për të testuar efikasitetin e pajisjeve e të sistemeve të sigurisë. Mbajtësi i licencës duhet të kryejë inspektime periodike të pajisjeve dhe të infrastrukturës nga subjekte të licencuara për këtë qëllim.

4. Skema e sigurisë së objektit, së bashku me procedurat e sigurisë, planin e dislokimit dhe transportin e sigurt të *cannabis*-it përgatitet nga drejtuesi teknik i subjektit të ngarkuar për ruajtjen e sigurinë fizike dhe miratohet nga shefi i Komisariatit të Policisë të juridiksionit ku ndodhet objekti dhe hartohet në 4 (katër) kopje origjinale, të cilat i vendosen në dispozicion nga 1 (një) kopje subjektit, Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it (Agjencia), subjektit të ngarkuar për ruajtjen dhe sigurinë fizike dhe Komisariatit të Policisë të juridiksionit ku ndodhet objekti.

5. Në rast defekti të sistemeve të sigurisë, subjekti i licencuar ose subjekti i ngarkuar për ruajtjen dhe sigurinë fizike, në varësi të parashikimeve në marrëveshjen e lidhur mes palëve, ka detyrimin të bëjë riparimin e menjëhershëm, por jo më shumë se 24 orë nga defekti. Subjekti njofton menjëherë Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it dhe Komisariatin e Policisë të juridiksionit ku ndodhet objekti.

6. Ruajtja dhe sigurimi i ambienteve ku ushtrohet aktiviteti kryhet nga subjekti i ngarkuar për ruajtjen dhe sigurinë fizike në bazë të kontratës së lidhur ndërmjet palëve, në zbatim të përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

7. Kontrata hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje origjinale, të cilat depozitohen nga 1 (një) kopje për subjektin, Agjencinë, subjektin e ngarkuar për ruajtjen dhe sigurinë fizike dhe Komisariatin e Policisë të juridiksionit ku ndodhet objekti.

III. RREGULLAT DHE TARIFAT PËR LIDHJEN E MARRËVESHJES PËR RUAJTJEN DHE SIGURINË FIZIKE, SI DHE PËR LËVIZJEN E AUTOMJETEVE TË DEDIKUARA PËR TRANSPORTIN E LËNDËVE TË PARA DHE PRODUKTEVE E NËNPRODUKTEVE TË *CANNABIS*-it PËR QËLLIME MJEKËSORE

1. Rregullat që duhet të ndiqen nga subjekti i licencuar për lidhjen e marrëveshjes për ruajtjen dhe sigurinë fizike, si dhe lëvizjen e automjeteve të dedikuara të tregtimit të lëndëve të para dhe produkteve janë, si më poshtë vijon:

a) Transporti i bimës, nënprodukteve dhe produkteve të saj duhet të kryhet me mjete të mbyllura që sigurojnë që ato të mos jenë të dukshme ose të identifikueshme nga jashtë automjetit dhe duhet të shoqërohen me procesverbalin përkatës për sasinë dhe llojin e produktit që transportohet.

b) Transporti i bimës, nënprodukteve dhe produkteve të saj të destinuara për përdorim mjekësor, të prodhuara nga bima e *cannabis*-it nga prodhuesi i licencuar, duhet të bëhet me mjete transporti të tilla që të sigurojnë ruajtjen e barit në temperatura as më të larta e as më të ulëta sesa ajo që thuhet në etiketim ose fletudhëzuesin e barit.

c) Subjekti i licencuar duhet të sigurojë që automjeti i transportit të jetë i mbyllur, i vulosur dhe i pajisur me GPS, me qëllim monitorimin pa ndërprerje të lëvizjes nga origjina në destinacion dhe të ketë kamera që monitorojnë materialin që transportohet, si dhe të ruhet dhe të shoqërohet nga shërbim i sigurisë deri në/nga pika e kalimit të kufirit sipas parashikimeve në marrëveshjen e lidhur mes palëve.

ç) Çdo lëvizje apo transportim kryhet vetëm pas marrjes së autorizimit nga Agjencia, e cila miraton dhe datën e propozuar të lëvizjes apo transportit, sipas formatit të miratuar nga kjo e fundit.

d) Në çdo rast, për çdo lëvizje, transportim të farërave, fidanëve, lëndës së parë, të bimës së *cannabis*-it mjekësor, nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të saj dhe mbetjeve/produkteve që asgjësohen nga një vend në një vend tjetër, subjekti i licencuar është i detyruar të njoftojë, të paktën 5 (pesë) ditë para lëvizjes së planifikuar, përmes Regjistrit Kombëtar të aktiviteteve të licencuara dhe të lejuara të bimës së *cannabis*-it dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Njoftimi përmban informacion lidhur me oraret e lëvizjes, itinerarin përkatës, të dhënat për çdo mjet që bën transportin, si dhe punonjësit e shërbimit që shoqërojnë ngarkesën.

dh) Subjekti i licencuar i garanton Agjencisë akses të pakufizuar dhe në kohë reale në sistemin e kamerave që monitorojnë të gjitha ambientet e njësisë, si dhe sistemin e kamerave që monitorojnë transportin e çdo materiali të lidhur me *cannabis*-in mjekësor, si dhe në imazhet filmike të ruajtura.

e) Procedurat doganore të eksportimit mund të kryhen pranë zyrave doganore kufitare të daljes nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, ku kryhen edhe kontrollet për sigurinë e mbrojtjen dhe, sipas rastit, këto procedura mund të fillojnë në zyrat doganore të brendshme kompetente për territorin ku janë vendosur ambientet e kultivimit dhe të përfundojë në zyrat doganore kufitare të daljes nga territori, në përputhje me legjislacionin doganor që rregullon procedurat e eksportit të mallrave. Subjekti i licencuar është i detyruar të njoftojë, të paktën 5 (pesë) ditë para procedurës doganore të import/eksportit Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

ë) Procedurat doganore të importimit të farërave dhe të fidanëve mund të kryhen pranë zyrave doganore kufitare të hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, ku kryhen edhe kontrollet për sigurinë e mbrojtjen dhe, sipas rastit, këto procedura mund të kryhen në zyrat doganore të brendshme kompetente për territorin ku janë vendosur ambientet e kultivimit, në përputhje me legjislacionin doganor që rregullon procedurat e eksportit të mallrave. Subjekti i licencuar është i detyruar të njoftojë, të paktën 5 (pesë) ditë para procedurës doganore të import/eksportit Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Subjekti njofton jo më pak se 24 orë para mbërritjes së farërave dhe fidanëve institucionin përgjegjës për inspektimin fitosanitar në pikën e inspektimit kufitar ku do të hyjnë produktet.

2. Tarifat për shërbimet e sigurisë që u ofrohen subjekteve të licencuara për kultivimin dhe përpunimin e *cannabis*-it për qëllime mjekësore janë sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it, subjektet e licencuara, si dhe subjektet e ngarkuara për ruajtjen dhe sigurinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1
MODEL I VETËDEKLARIMIT PËR GATISHMËRINË PËR TË LIDHUR MARRËVESHJE ME STRUKTURËN PËRGJEGJËSE TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR RENDIN DHE SIGURINË PUBLIKE

VETËDEKLARIM
PËR GATISHMËRINË PËR TË LIDHUR MARRËVESHJE ME STRUKTURËN PËRGJEGJËSE TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR RENDIN DHE SIGURINË PUBLIKE

Në mbështetje të shkronjës "e", të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 61/2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale",

Unë i nënshkruari _____,
(emër, atësia, mbiemër)

Deklaroj gatishmërinë për të lidhur marrëveshje me strukturën përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, në nivel qendror dhe vendor, për të garantuar aksesin për inspektim ndaj shoqërisë private të sigurisë fizike që mbikëqyr mjediset e kultivimit të bimës së *cannabis*-it dhe nënprodukteve të tij, si dhe lëvizjes së automjeteve të dedikuara të tregtimit të lëndëve të para dhe produkteve, sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave nr.____ datë____.

Përfaqësuesi i personit juridik

_____
(Emër Mbiemër, firmë, vulë)

SHTOJCA NR. 2

Tarifat për shërbimin që u ofrohen subjekteve të licencuara për kultivimin dhe përpunimin e *cannabis*-it për qëllime mjekësore:

TARIFAT E SHËRBIMEVE		
I	SHËRBIM RUAJTJEJE ME PUNONJËS SHËRBIMI SIGURIE (për ambiente, urë/tra kontrolli etj.)	
	Lloji i shërbimit të ofruar	*Tarifë/punonjës në muaj (lek pa TVSH)*
1	Shërbim ruajtjeje me një punonjës shërbimi (tri turne)	87 900
	Shërbim sigurie me urë kontrolli për një punonjës (turni i parë)	76 000
	Shërbim sigurie me urë kontrolli për një punonjës (turni i dytë)	80 700
	Shërbim sigurie me urë kontrolli për një punonjës (turni i tretë)	107 000
II	SHËRBIM REAGIMI ME GRUP VERIFIKIMI SINJALESH	
	Lloji i shërbimit të ofruar	*Tarifë/muaj (lek pa TVSH)*
	Shërbim reagimi me grup verifikimi sinjalesh	11 300
III	SHËRBIM RUAJTJEJE ME SISTEME ELEKTRONIKE*	
	Lloji i shërbimit të ofruar	*Tarifë/shërbim në muaj (lek pa TVSH)*
	Shërbim sigurie për vëzhgim me kamera, dhe alarm	11 800
IV	SHËRBIM SIGURIMI PËR TRANSPORTIN	
	Shërbim	*Tarifë/ditë për lëvizje (lek pa TVSH)*
1	Shërbim ruajtjeje me shoqërim gjatë transportit me një makinë (deri në 50 km)	14 800
2	Shërbim ruajtjeje me shoqërim gjatë transportit me një makinë (për çdo 50 km shtesë)	29 600

* Pajisjet elektronike ose trau i parkimit, bravat elektrike, sistemi *face detection*, akses kontrolli, mund të vihen në dispozicion nga subjekti i licencuar ose subjekti që ofron shërbimin e sigurisë fizike, sipas përcaktimeve në marrëveshjen e lidhur me palëve. Nëse pajisjet ofrohen nga subjekti i ngarkuar me shërbimin e sigurisë pagesa e tyre përcaktohet sipas marrëveshjes së lidhur mes palëve.

VENDIM
Nr. 9, datë 9.1.2025

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË TARIFAVE PËR RUAJTJEN DHE SIGURINË FIZIKE PËR SUBJEKTET E LEJUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "d", të pikës 1, të nenit 23, të ligjit nr. 61/2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale", me propozimin e ministrit të Brendshëm, të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kuptim të këtij vendimi, subjekt i ngarkuar për ruajtjen dhe sigurinë është SHPSF-ja e pajisur me licencë të nënkategorive 1.3.A. dhe 1.3.B ose "*Illyrian Guard*", sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin privat të sigurisë fizike.

2. Subjekti vetëdeklaron gatishmërinë për lidhjen e marrëveshjes paraprake me subjektin përgjegjës për ruajtjen dhe sigurinë fizike, sipas modelit në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Subjekti i lejuar lidh marrëveshje për ruajtjen dhe sigurinë fizike me subjektin e ngarkuar për ruajtjen dhe sigurinë për periudhën e ushtrimit të aktivitetit.

4. Marrëveshja paraprake duhet të përmbajë:

a) të dhënat e kërkuesit;

b) të dhënat e ofruesit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike;

c) kohëzgjatjen e ruajtjes nga ofruesi i shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike;

ç) tarifat që do të aplikohen për lidhjen e marrëveshjes;

d) nënshkrimin e palëve.

5. Në rastin kur subjekti i lejuar kultivon bimën e *cannabis*-it për qëllime industriale vetëm për përftimin e farërave dhe të fibrave, zbatohen rregullat për standardet e sigurisë, si më poshtë vijon:

a) Subjekti i lejuar lidh marrëveshje me subjektin përgjegjës për ruajtjen dhe sigurinë fizike për monitorimin me kamera dhe shërbim reagimi me grup verifikimi sinjalesh;

b) Sistemi i kamerave monitoron sipërfaqen e kultivuar brenda dhe jashtë ambienteve të njësisë së prodhimit, duke u orientuar në mënyrë që të sigurohet identifikimi i qartë dhe i sigurt i ambienteve dhe i të gjithë individëve që aksesojnë apo lëvizin brenda tyre apo në ambientet e jashtme pranë rrethimit;

c) Për transportimin e bimës së *cannabis*-it industrial për përftimin e farërave dhe fibrave, nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të saj dhe mbetjeve/produkteve të saj që asgjësohen nga një vend në një vend tjetër, subjekti i lejuar është i detyruar të njoftojë, të paktën 5 (pesë) ditë para lëvizjes së planifikuar, përmes Regjistrit Kombëtar të aktivitetit të licencuar dhe të lejuar të bimës së *cannabis*-it, Agjencinë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Njoftimi përmban informacion lidhur me oraret e lëvizjes, itinerarin përkatës, si dhe të dhënat për çdo mjet që bën transportin.

6. Në rastin kur subjekti i lejuar kultivon bimën e *cannabis*-it industrial për përftimin e lules, zbatohen rregullat vijuese për standardet e sigurisë:

a) Ambientet duhet të jenë të monitoruara në vazhdimësi me sistem të kamerave CCTV, i pajisur me *reader* të inkorporuar dhe sensorë lëvizjeje, me rezolucion të lartë, prej të paktën 1280 x 720, me rreze infra të kuqe, përfshirë hapësirën 20 metra jashtë rrethimit, e cila duhet të jetë e ndriçuar. Imazhet filmike të sistemit të kamerave duhet të ruhen të paktën për 60 ditë në NRV/server dhe të paktën për një periudhë 1-vjeçare në memorie *Cloud*, me vendndodhje në një nga vendet e BE-së;

b) Sistemi i kamerave CCTV monitoron sipërfaqen, brenda dhe jashtë ambienteve të njësisë së prodhimit, duke u orientuar në mënyrë që të sigurohet identifikim i qartë dhe i sigurt i ambienteve dhe i të gjithë individëve që aksesojnë apo lëvizin brenda tyre apo në ambientet e jashtme pranë rrethimit;

c) Në varësi të vlerësimit të rrezikut dhe në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit, bëhet lidhja e sinjalit të alarmit, në nivel qendror dhe /ose vendor, me sallat e komandimit/informacionit të Policisë së Shtetit;

ç) Sipërfaqja ku ushtrohet aktiviteti ruhet 24 orë pa ndërprerje nga subjekti i ngarkuar për ruajtjen dhe sigurinë fizike që përfshin dhe shërbim reagimi me grup verifikimi sinjalesh;

d) Për rastet kur kultivimi kryhet në ambiente të mbyllura, muri i jashtëm i godinës duhet të jetë mur i qëndrueshëm;

dh) Për rastet kur kultivimi kryhet në ambiente të hapura ose të mbrojtura rrethohet nga jashtë me mur të qëndrueshëm me lartësi 4 m nga toka;

e) Hyrja në ambientet e njësisë është e kufizuar dhe mundësohet përmes një porte hekuri që garanton aksesin vetëm për personat dhe mjetet e autorizuara, si dhe monitorohet nga sistemi i kamerave CCTV, të përcaktuara në shkronjën "a" të kësaj pike;

ë) Porta e hyrjes kontrollohet nga personel i autorizuar për sigurinë, i cili mban evidencë për çdo hyrje-dalje të personave, automjeteve dhe mallrave;

f) Materialet teknike, të cilat garantojnë sigurinë dhe monitorimin, vendosen në një dhomë të veçantë të dedikuar brenda perimetrit të sipërfaqes ku ushtrohet aktiviteti, në të cilën ka akses vetëm personeli përgjegjës për sigurinë;

g) Rregullat që duhet të ndiqen nga subjekti gjatë transportit janë, si më poshtë vijon:

i. transporti i bimës, nënprodukteve dhe produkteve të saj duhet të kryhet me mjete të mbyllura që sigurojnë që ato të mos jenë të dukshme ose të identifikueshme nga jashtë automjetit dhe duhet të shoqërohen me procesverbalin përkatës për sasinë dhe llojin e produktit që transportohet;

ii. transporti i bimës, nënprodukteve dhe produkteve të saj duhet të bëhet me mjete transporti të tilla që të sigurojnë ruajtjen e tyre në kushte optimale sipas kërkesës së vendit pritës;

iii. subjekti duhet të sigurojë që automjeti i transportit të jetë i mbyllur, i vulosur dhe i pajisur me GPS, me qëllim monitorimin pa ndërprerje të lëvizjes nga origjina në destinacion dhe të ketë kamera që monitorojnë materialin që transportohet, si dhe të ruhet dhe të shoqërohet nga shërbim i sigurisë deri në/nga pika e kalimit të kufirit, sipas parashikimeve në marrëveshjen e lidhur mes palëve;

iv. çdo lëvizje apo transportim kryhet vetëm pas marrjes së autorizimit nga Agjencia e cila miraton dhe datën e propozuar të lëvizjes apo transportit, sipas formatit të miratuar nga kjo e fundit.

v. në çdo rast, për çdo lëvizje të lëndës së parë të bimës së *cannabis*-it industrial për përftimin e lules, nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të saj dhe mbetjeve/produkteve të saj që asgjësohen, nga një vend në një vend tjetër, subjekti i lejuar është i detyruar të njoftojë, të paktën 5 (pesë) ditë para lëvizjes së planifikuar, përmes Regjistrit Kombëtar të aktivitetit të licencuar dhe të lejuar të bimës së *cannabis*-it, Agjencinë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Njoftimi përmban informacion lidhur me oraret e lëvizjes, itinerarin përkatës, të dhënat për çdo mjet që bën transportin, si dhe punonjësit e shërbimit që shoqërojnë ngarkesën.

7. Procedurat doganore të eksportimit mund të kryhen pranë zyrave doganore kufitare të daljes nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, ku kryhen edhe kontrollet për sigurinë e mbrojtjen dhe, sipas rastit, këto procedura mund të fillojnë në zyrat doganore të brendshme kompetente për territorin ku janë vendosur ambientet e kultivimit dhe të përfundojnë në zyrat doganore kufitare të daljes nga territori, në përputhje me legjislacionin doganor që rregullon procedurat e eksportit të mallrave. Subjekti i lejuar është i detyruar të njoftojë, të paktën 5 (pesë) ditë para procedurës doganore të import/eksportit Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

8. Mbajtësi i lejes duhet të ketë dhe të ndjekë procedura për të ruajtur dhe testuar efikasitetin e pajisjeve e të sistemeve të sigurisë. Mbajtësi i lejes duhet të kryejë inspektime periodike të pajisjeve dhe infrastrukturës nga subjekte të licencuara për këtë qëllim.

9. Në rast defekti të sistemeve të sigurisë, subjekti i lejuar ose subjekti i ngarkuar për ruajtjen dhe sigurinë fizike, në varësi të parashikimeve në marrëveshjen e lidhur mes palëve, ka detyrimin të bëjë riparimin e menjëhershëm, por jo më shumë se 24 orë nga defekti. Subjekti njofton menjëherë Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it dhe Komisariatin e Policisë të juridiksionit ku ndodhet objekti.

10. Skema e sigurisë së objektit së bashku me procedurat e sigurisë, planin e dislokimit dhe transportin e sigurt të *cannabis*-it përgatitet nga drejtuesi teknik i subjektit të ngarkuar për ruajtjen dhe sigurinë fizike dhe miratohet nga Shefi i Komisariatit të Policisë të juridiksionit ku ndodhet objekti dhe hartohet në 4 (katër) kopje origjinale të cilat i vendosen në dispozicion nga 1 (një) kopje subjektit, Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it (Agjencia), subjektit të ngarkuar për ruajtjen dhe sigurinë fizike dhe Komisariatit të Policisë të juridiksionit ku ndodhet objekti.

11. Ruajtja dhe sigurimi i ambienteve ku ushtrohet aktiviteti kryhet nga subjekti i ngarkuar për ruajtjen dhe sigurinë fizike në bazë të kontratës

së lidhur ndërmjet palëve, në zbatim të përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

12. Kontrata hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje origjinale të cilat depozitohen nga 1 (një) kopje për subjektin, Agjencinë, subjektin e ngarkuar për ruajtjen dhe sigurinë fizike dhe Komisariatin e Policisë të juridiksionit ku ndodhet objekti.

13. Për transportimin e farërave dhe fidanëve të bimës së *cannabis*-it industrial subjekti i lejuar është i detyruar të njoftojë, të paktën 5 (pesë) ditë para lëvizjes së planifikuar, përmes Regjistrit Kombëtar të aktivitetit të licencuar dhe të lejuar të bimës së *cannabis*-it, Agjencinë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Njoftimi përmban informacion lidhur me oraret e lëvizjes, itinerarin përkatës, të dhënat për çdo mjet që bën transportin si dhe punonjësit e shërbimit që shoqërojnë ngarkesën.

14. Subjekti i lejuar i garanton Agjencisë akses të pakufizuar dhe në kohë reale në sistemin e kamerave që monitorojnë të gjitha ambientet e njësisë, si dhe sistemin e kamerave që monitorojnë transportin e çdo materiali të lidhur me *cannabis*-in industrial, si dhe në imazhet filmike të ruajtura.

15. Procedurat doganore të importimit të farërave dhe fidanëve të bimës së *cannabis*-it për qëllime industriale mund të kryhen pranë zyrave doganore kufitare të hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, ku kryhen edhe kontrollet për sigurinë e mbrojtjen dhe, sipas rastit, këto procedura mund të kryhen në zyrat doganore të brendshme kompetente për territorin ku janë vendosur ambientet e kultivimit, në përputhje me legjislacionin doganor që rregullon procedurat e import/eksportit të mallrave.

16. Subjekti njofton jo më pak se 24 orë para mbërritjes së farërave dhe fidanëve institucionin përgjegjës për inspektimin fitosanitar në pikën e inspektimit kufitar ku do të hyjnë produktet.

17. Tarifat për shërbimet e sigurisë, që u ofrohen subjekteve të lejuara për kultivimin dhe përpunimin e *cannabis*-it për qëllime industriale, janë sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

18. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it, subjektet e lejuara, si dhe subjektet e ngarkuara për ruajtjen dhe sigurinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1
MODEL I FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT PËR LIDHJEN E MARRËVESHJES PARAPRAKE PËR RUAJTJEN DHE SIGURINË FIZIKE

FORMULAR VETËDEKLARIMI

Në mbështetje të shkronjës "d", të pikës 1, të nenit 23, të ligjit nr. 61/2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale",

Unë i nënshkruari _____,
(emër, atësia, mbiemër)

deklaroj gatishmërinë për të lidhur marrëveshje me subjektin e ngarkuar për ruajtjen dhe sigurinë fizike sipas përcaktimeve në vendimin nr. ___, datë _____të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave dhe tarifave për lidhjen e marrëveshjes paraprake për ruajtjen dhe sigurinë fizike, për subjektet e lejuara".

Përfaqësuesi i personit juridik

_____
(Emër Mbiemër, firmë, vulë)

SHTOJCA NR. 2

Tarifat për shërbimin që u ofrohen subjekteve të lejuara për kultivimin dhe përpunimin e *cannabis*-it për qëllime industriale:

TARIFAT E SHËRBIMEVE		
I	SHËRBIM RUAJTJEJE ME PUNONJËS SHËRBIMI SIGURIE (për ambiente, urë/tra kontrolli etj.)	
	Lloji i shërbimit të ofruar	*Tarifë/punonjës në muaj (lek pa TVSH)*
1	Shërbim ruajtjeje me një punonjës shërbimi (tre turne)	87 900
	Shërbim sigurie me urë kontrolli për një punonjës (turni i parë)	76 000
	Shërbim sigurie me urë kontrolli për një punonjës (turni i dytë)	80 700
	Shërbim sigurie me urë kontrolli për një punonjës (turni i tretë)	107 000
II	SHËRBIM REAGIMI ME GRUP VERIFIKIMI SINJALESH	
	Lloji i shërbimit të ofruar	*Tarifë/muaj (lek pa TVSH)*
	Shërbim reagimi me grup verifikimi sinjalesh	11 300
III	SHËRBIM RUAJTJEJE ME SISTEME ELEKTRONIKE*	
	Lloji i shërbimit të ofruar	*Tarifë/shërbim në muaj (lek pa TVSH)*
	Shërbim sigurie për vëzhgim me kamera, dhe alarm	11 800
IV	SHËRBIM SIGURIMI PËR TRANSPORTIN	
	Shërbim	*Tarifë/ditë për lëvizje (lek pa TVSH)*
1	Shërbim ruajtjeje me shoqërim gjatë transportit me një makinë (deri në 50 km)	14 800
2	Shërbim ruajtjeje me shoqërim gjatë transportit me një makinë (për çdo 50 km shtesë)	29 600

* Pajisjet elektronike ose trau i parkimit, bravat elektrike, sistemi *face detection*, akses kontrolli, mund të vihen në dispozicion nga subjekti i licencuar ose subjekti që ofron shërbimin e sigurisë fizike sipas përcaktimeve në marrëveshjen e lidhur me palëve. Nëse pajisjet ofrohen nga subjekti i ngarkuar me shërbimin e sigurisë pagesa e tyre përcaktohet sipas marrëveshjes së lidhur mes palëve.

VENDIM
Nr. 11, datë 9.1.2025

PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË TEATRIT KOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Altin Basha, drejtor i Përgjithshëm i Teatrit Kombëtar, lirohet nga kjo detyrë.
2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Teatri Kombëtar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 14, datë 9.1.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 55, DATË 6.2.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR AUTORIZIMIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE, QË OFROJNË NDIHMË JURIDIKE PARËSORE TË GARANTUAR NGA SHTETI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 15, të ligjit nr. 111/2017, "Për

ndihmën juridike të garantuar nga shteti", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 55, datë 6.2.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 5 dhe 6 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"5. Organizatat jofitimprurëse, që kërkojnë pajisjen me autorizim nga ministri i Drejtësisë, paraqesin aplikimin *on-line* për autorizim, si dhe dokumentacionin shoqërues, si më poshtë vijon:

a) Dokumentacionin që provon përvojë në ofrimin e ndihmës juridike parësore, të paktën në 3 (tri) vjet të veprimtarisë së tyre, duke përfshirë:

i. listën e rasteve të trajtuara ose projekteve të ndihmës juridike parësore të zhvilluara nga organizata gjatë 3 (tri) vjetëve, si dhe të dhëna statistikore për përfituesit e ndihmës parësore nga projektet e ndihmës juridike parësore;

ii. raportet përfundimtare për secilin rast ose raportet vjetore për projektet e listuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore, si dhe pasqyrat financiare për to;

iii. buxhetin total të secilit projekt, donatorët përkatës, si dhe listën e ekspertëve të brendshëm e të jashtëm, të përfshirë në këto projekte;

iv. në rast se organizata jofitimprurëse nuk ka zbatuar një projekt të posaçëm për ofrimin e ndihmës juridike parësore, por ky aktivitet është një komponent i një projekti tjetër, paraqiten dokumentet sipas nënndarjeve "i" deri në "iii", të kësaj shkronje, vetëm për këtë komponent që lidhet me ofrimin e ndihmës juridike parësore.

b) Formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të anëtarëve të organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv.

6. Aplikimi *on-line* për autorizim dhe dokumentacioni i përcaktuar në pikën 5, të këtij vendimi, dorëzohet elektronikisht përmes portalit unik qeveritar "*e-Albania*", në adresë të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Për shqyrtimin e përmbushjes së kritereve ligjore, nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, organet publike plotësojnë dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) vendimin e gjykatës për regjistrimin e organizatës jofitimprurëse;

b) kopjen e statutit të organizatës jofitimprurëse, ku specifikohet si pjesë e veprimtarisë ofrimi i ndihmës juridike, të depozituar në gjykatë;

c) vërtetimin nga organet tatimore se organizata jofitimprurëse i ka përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet;

ç) vërtetim nga gjykata se organizata jofitimprurëse nuk është në procedurë falimenti dhe/ose likuidimi;

d) vërtetim nga prokuroria dhe gjykata se anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv të organizatës jofitimprurëse nuk janë në proces hetimi apo gjykimi për çështje që cenojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike;

dh) certifikatën e gjendjes gjyqësore të anëtarëve të organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv.".

2. Në fjalinë e parë, të pikës 10, fjalët "... verifikon dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesit për marrjen e autorizimit ..." zëvendësohen me "... shqyrton aplikimin, verifikon dokumentacionin e administruar ...".

3. Në fund të pikës 11 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

"Kundër urdhrit të ministrit për refuzimin e aplikimit për autorizim mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente.".

4. Pikat 12 dhe 13 shfuqizohen.

5. Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"14. Autorizimi i ministrit të Drejtësisë jepet pa afat. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas verifikon çdo 2 (dy) vjet përmbushjen e kritereve ligjore nga organizatat jofitimprurëse. Organizatat jofitimprurëse, që janë autorizuar nga ministri i Drejtësisë, njoftojnë Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas për çdo ndryshim që lidhet me plotësimin e kritereve ligjore për dhënien e autorizimit, brenda 3 (tri) ditëve nga data e kryerjes së ndryshimit.".

6. Në pikën 16 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në fjalinë e parë, fjalët "... mund të revokojë ..." zëvendësohen me "... ose kryesisht, mund të shfuqizojë ...";

b) Pas shkronjës "a" shtohet shkronja "a/1", me këtë përmbajtje:

"a/1) mospërmbushjen e kritereve ligjore.".

c) Në shkronjën "ç", fjala "... nuk ..." hiqet.

7. Në pikën 17, fjalët "... Revokimi i autorizimit i njoftohet organizatës jofitimprurëse ..." zëvendësohen me "... Shfuqizimi i autorizimit i njoftohet organizatës jofitimprurëse nëpërmjet portalit unik qeveritar "*e-Albania*", te seksioni "Dokumentet e mia", me vulë elektronike ...".

8. Në pikën 18 fjala "... revokimin ..." zëvendësohet me "... shfuqizimin ...".

II. Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas verifikon përmbushjen e kritereve ligjore nga organizatat jofitimprurëse, të autorizuara nga ministri i Drejtësisë, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Pas verifikimit, ministri i Drejtësisë urdhëron:

a) kryerjen e ndryshimeve përkatëse, me qëllim që vlefshmëria e autorizimit të jetë pa afat; ose

b) shfuqizimin e autorizimit, nëse vërtetohet mospërmbushja e kritereve ligjore.

III. Detyrimi për të paraqitur aplikimin *on-line* për autorizim dhe dokumentacionin shoqërues, elektronikisht përmes portalit unik qeveritar "*e-Albania*", si dhe detyrimi për të njoftuar shfuqizimin e autorizimit, të vulosur elektronikisht, nëpërmjet portalit unik qeveritar "*e-Albania*", hyn në fuqi pas ngritjes së sistemit të menaxhimit të çështjeve (CMS) dhe platformës *on-line* (OP) për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas. Deri në ngritjen dhe funksionimin e plotë të sistemit, aplikimi për pajisjen me autorizim paraqitet pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, ndërsa tërheqja e autorizimit bëhet pranë Ministrisë së Drejtësisë.

IV. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 15, datë 9.1.2025

PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PËR VITIN 2025

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore të paketës së shërbimeve të ofruara në spitalet publike, sipas listës së shërbimeve në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Spitali e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me standardet, treguesit e cilësisë e të performancës, protokollet e diagnozës e të trajtimit, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

3. Buxheti për mbulimin e paketës së shërbimeve spitalore, sipas listës së shërbimeve që ofron çdo spital, ndahet sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratat me spitalet për financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore të ofruara prej tyre, në përputhje me indikatorët e performancës spitalore.

5. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor financon paketën e shërbimeve spitalore të kontraktuara me këto metoda:

a) Buxhetim me zëra shpenzimesh, për:

i. paga dhe shpenzime të tjera lidhur me pagën e personelit;

ii. kontribute për sigurime shëndetësore e shoqërore të personelit;

iii. mallra e shërbime të tjera.

b) Buxhetim për pagesën e paketave të shërbimeve me çmime të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Buxhetimi detajohet për çdo

spital në zëra shpenzimesh me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;

c) Buxhetim për spitalet Durrës e "Memorial" Fier. Detajimi në zëra shpenzimesh i buxhetit miratohet nga bordet e këtyre spitaleve. Fondi financon dy spitalet nëpërmjet transfertave në llogaritë bankare që kanë spitalet në bankat e nivelit të dytë.

6. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor financon spitalet, në zbatim të vendimit nr. 258, datë 24.4.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës". Fondi rishikon financimin e spitaleve për këtë kontratë gjatë vitit, me vendim të Këshillit Administrativ, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

7. Spitali është përgjegjës për zbatimin e buxhetit të kontraktuar, sipas zërave të përcaktuar të buxhetit, në përputhje me indikatorët dhe aktivitetin e shërbimit spitalor.

8. Rishpërndarja e buxhetit ndërmjet spitaleve bëhet brenda një kufiri prej 3 (tre) % të buxhetit të spitaleve, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

9. Një fond jo më i madh se 30 (tridhjetë) % e buxhetit vjetor, i planifikuar për shërbimet spitalore, mbahet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për ta shpërndarë gjatë vitit, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, përkatësisht, për:

a) financimin e shërbimit spitalor gjatë vitit;

b) pagesat e paketave të shërbimeve të veçanta, të ofruara nga shërbimet spitalore, publike e jopublike, brenda vendit, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) pagesat për kujdes shëndetësor në institucione jopublike, brenda e jashtë vendit, sipas miratimit, rast pas rasti, me vendim të Këshillit të Ministrave;

ç) pagesat për kujdes shëndetësor, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara;

d) pagesat e shërbimeve të kryera për llogari të spitaleve publike nga operatorë të kontraktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,

dh) transferta për individët (mjekë në shërbimet spitalore).

10. Shpenzimet kapitale për investimet në spitale mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor vlerëson kërkesat e spitaleve (rajonale/bashkiake) për investimet dhe ia paraqet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për miratim. Spitalet universitare paraqesin kërkesën për investime në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

11. Burime të tjera financimi për spitalet janë fondet e krijuara nga të ardhurat e realizuara gjatë veprimtarisë së tyre dhe nga dhurimet, të cilat përdoren tërësisht nga vetë spitali. Përdorimi i të ardhurave dytësore miratohet nga bordi drejtues i spitaleve për spitalet që kanë përfituar autonominë menaxheriale. Për spitalet e tjera, përdorimi i të ardhurave bëhet bazuar në procedurat e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Këto të ardhura vlerësohen si të ardhura jashtë limitit, të cilat mbarten në vitin buxhetor pasardhës.

12. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për raste të vlerësuara nga ajo ose me kërkesë të autoriteteve kontraktuese, spitaleve, mund të zhvillojë procedura të përqendruara prokurimi për disa mallra, shërbime dhe investime.

13. Spitali zbaton sistemin e referimit dhe tarifat për shërbimet me pagesë, të miratuara nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me përjashtim të spitaleve që kanë përfituar autonominë financiare.

14. Numri i përgjithshëm i punonjësve të spitaleve është 13 200 (trembëdhjetë mijë e dyqind) veta, të cilët paguhen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

15. Për raste të veçanta të mungesës së mjekut specialist në shërbime të ndryshme të spitaleve rajonale, bashkiake, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, brenda numrit të përgjithshëm të personelit spitalor, urdhëron kontraktimin, për një periudhë të caktuar, të mjekëve specialistë. Mjekët e përcaktuar në këtë pikë, përveç pagës, trajtohen financiarisht me një bonus deri në 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë në muaj. Vlera e bonusit përcaktohet, rast pas rasti, nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bazuar në vlerësimin e komisionit përkatës. Ky bonus, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, trajtohet sipas shkronjës "e", të pikës 2, të kreut II, të vendimit nr.

77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor", të ndryshuar.

16. Mjekët e kontraktuar, sipas pikës 15, të këtij vendimi, nuk e përfitojnë shpërblimin sipas shkronjave "a" e "b", të pikës 17.6, të vendimit nr. 424, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave e shtesave mbi pagë, kompensime dhe trajtime të tjera financiare të punonjësve të sistemit shëndetësor, në institucionet shëndetësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat shëndetësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit".

17. Për spitalet rajonale, bashkiake, që nuk plotësojnë nevojat me personel mjek të strukturës në shërbimin e urgjencës, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale urdhëron kontraktimin e mjekëve të përgjithshëm dhe kryerjen e shërbimit nga mjekë të qendrave shëndetësore të shërbimit parësor.

18. Numri i pedagogëve me kontratë shërbimi për spitalet universitare miratohet çdo vit nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Masa e shpërblimit mujor të mjekëve pedagogë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, bazohet në aktivitetin mjekësor e në kohën e angazhimit në strukturat shëndetësore universitare dhe nuk mund të jetë më e lartë se masa e shpërblimit mujor të drejtuesit të shërbimit me gradën "Doktor i shkencave". Pagesa e tyre bëhet nga buxheti për shërbimet e spitalit.

19. Financimi i institucioneve dhe i shërbimeve, të përcaktuara në shtojcën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, bëhet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor vetëm kundrejt shtesave përkatëse në buxhet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

20. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2025.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1
LISTA E SHËRBIMEVE SPITALORE QË DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

I. SPITALET UNIVERSITARE

1. Shërbimi i kardiologjisë;
2. Shërbimi i kardiokirurgjisë;
3. Shërbimi i kirurgjisë angiovaskulare;
4. Shërbimi i hematologjisë;
5. Shërbimi i gastro-hepato-enterologjisë;
6. Shërbimi i endokrinologjisë;
7. Shërbimi i nefrologjisë dhe hemodializës;
8. Shërbimi i anestezi-reanimacionit;
9. Shërbimi i urgjencave polivalente;
10. Shërbimi i hipertonisë dhe i mjekësisë interne;
11. Shërbimi i alergologjisë;
12. Shërbimi i reumatologjisë;
13. Shërbimi i dermatologjisë;
14. Shërbimi i traumatologjisë;
15. Shërbimi i ortopedisë;
16. Shërbimi i okulistikës;
17. Shërbimi i ORL-së;
18. Shërbimi i kirurgjisë oro-maksilo-faciale (OMF);
19. Shërbimi i urgjencës kirurgjikale;
20. Shërbimi i kirurgjisë digjestive;
21. Shërbimi i urologjisë;
22. Shërbimi i djegie-plastikës;
23. Shërbimi i neurologjisë;
24. Shërbimi neurovaskular (stroke dhe poststroke);
25. Shërbimi i neurokirurgjisë;
26. Shërbimi i onkologjisë;
27. Shërbimi i sëmundjeve infektive;
28. Shërbimi i pediatrisë së specialiteteve;
29. Shërbimi i onkohematologjisë pediatrike;
30. Shërbimi i pediatrisë infektive;
31. Shërbimi i urgjencës dhe i pediatrisë së përgjithshme;
32. Shërbimi i kirurgjisë infantile;
33. Shërbimi i reanimacionit pediatrik;
34. Shërbimi i laboratorëve (klinikë-biokimikë, mikrobiologjikë, imunologjikë, anatomisë patologjike);
35. Shërbimi i gjenetikës mjekësore;
36. Shërbimi i imazherisë dhe i mjekësisë nukleare;
37. Shërbimi i mjekësisë rehabilituese;

38. Shërbimi i statistikave;
39. Shërbimi i pneumologjisë;
40. Kirurgjia torakale;
41. Shërbimi i gjinekologjisë;
42. Shërbimi i obstetrikës;
43. Shërbimi i patologjisë së barrës;
44. Shërbimi i neonatologjisë;
45. Shërbimi i farmacisë;
46. Shërbimi i konsultave të specializuara ambulatore;
47. Shërbimi i toksikologjisë klinike;
48. Shërbimi i psikiatrisë (QSUT);
49. Kontrolli i infeksioneve spitalore;
50. Shërbimi i urgjencës paraspitalore;
51. Banka e gjakut.

II. QENDRA SPITALORE RAJONALE

II.A. Shërbimet e qendrës spitalore rajonale përcaktohen rast pas rasti në urdhrin e ministrit për ngritjen e qendrës spitalore rajonale.

1. Shërbimi i urgjencës;
2. Shërbimi Universitar i Sëmundjeve Polmonare;
3. Shërbimi i mjekësisë interne;
4. Shërbimi i kardiologjisë dhe hemodinamikës;
5. Shërbimi i kardiokirurgjisë;
6. Shërbimi i kirurgjisë abdominale dhe ortopedike;
7. Shërbimi i kirurgjisë torakale;
8. Shërbimi i anestezi-reanimacionit;
9. Shërbimi imazherisë;
10. Shërbimi i referencës së tuberkulozit;
11. Shërbimi i laboratorit;
12. Shërbimi i konsultave;
13. Shërbimi i pediatrisë;
14. Shërbimi i farmacisë;
15. Njësi komunitare lindjeje;
16. Riaftësim dhe rehabilitim.

III. SPITALET NË NIVEL QARKU (SPITALET RAJONALE)

Spitalet publike të përgjithshme në nivel qarku ofrojnë:

1. Shërbimin e urgjencës;
2. Shërbimin e mjekësisë së përgjithshme;
3. Shërbimin e kirurgjisë së përgjithshme, ortopedi-traumatologjisë, urologjisë, ORL, okulistikës, angiologjisë, *max-facial*;
4. Shërbimin e obstetrikë-gjinekologjisë;
5. Shërbimin e neonatologjisë;
6. Shërbimin e pediatrisë;
7. Shërbimin e imazherisë;
8. Shërbimin e mjekësisë rehabilituese;
9. Shërbimin e anatomisë dhe histologjisë patologjike;
10. Shërbimin e laboratorëve kliniko-biokimikë të mikrobiologjisë;
11. Shërbimin e anestezi-reanimacionit;
12. Shërbimin e farmacisë;
13. Shërbimin e onkologjisë (kimioterapisë, kujdesi paljativ);
14. Kontrollin e infeksioneve spitalore;
15. Shërbimin psikosocial;
16. Shërbimin e konsultave të specializuara (poliklinika e specialiteteve);
17. Bankën e gjakut.

IV. SPITALET NË NIVEL BASHKIE

Spitalet publike të përgjithshme në nivel bashkie ofrojnë:

1. Shërbimin e urgjencës;
2. Shërbimin e mjekësisë së përgjithshme;
3. Shërbimin e kirurgjisë së përgjithshme;
4. Shërbimin e pediatrisë dhe obstetrikë-gjinekologjisë, neonatologji;
5. Shërbimin e imazherisë;
6. Shërbimin e laboratorëve kliniko-biokimikë të mikrobiologjisë;
7. Shërbimin e anestezi-reanimacionit;
8. Shërbimin e farmacisë;
9. Shërbimin ambulator të specializuar;
10. Bankën e gjakut.

V. SPITALET DITORE

1. Ndihmë e parë mjekësore për trajtim dhe kurim brenda 24 orëve.

SHTOJCA NR.2
BUXHETI I SHËRBIMIT SPITALOR 2025

INSTITUCIONET	ARTIKUJT						total
	art.600	**art.601**	**art.602**	**art. 602 PPP laboratorë**	**604**	**rezerve**	**total**
QSR BERAT	538,600	87,000	200,000	64,000			889,600
BULQIZË	109,700	18,100	30,000				157,800
DELVINË	52,360	8,620	7,000				67,980
DEVOLL	66,870	11,050	12,000				89,920
DIBËR	385,980	63,000	135,000	33,000			616,980
ELBASAN	693,100	113,950	250,000	110,000			1,167,050
FIER	547,000	89,950	218,000	115,000			969,950
GRAMSH	168,070	27,650	35,000				230,720
GJIROKASTËR	318,600	51,650	120,000	36,000			526,250
HAS	67,320	11,070	16,000				94,390
KOLONJË	111,760	18,000	20,000				149,760
KORÇË	613,200	101,250	295,000	85,000			1,094,450
KRUJË	177,320	29,280	32,000				238,600
KUKËS	373,200	61,400	126,000	37,000			597,600
KURBIN	123,850	20,680	37,000				181,530
LEZHË	380,400	62,240	180,000	65,000			687,640
LIBRAZHD	214,100	34,960	54,000				303,060
LUSHNJË	318,450	51,980	107,000	46,000			523,430
MALËSI E MADHE	34,550	5,580	6,600				46,730
MALLAKASTËR	57,600	9,420	13,000				80,020
MAT	187,100	30,640	40,000				257,740
MIRDITË	140,550	22,800	30,000				193,350
PEQIN	47,100	7,840	7,500				62,440
PËRMET	108,050	17,650	35,000				160,700
POGRADEC	245,650	40,200	84,000				369,850
PUKË	123,850	19,900	40,000				183,750
SARANDË	226,650	36,900	120,000	35,000			418,550
SKRAPAR	114,100	13,460	18,000				145,560
SHKODËR	791,500	130,530	320,000	67,000			1,309,030
TEPELENË	115,300	18,240	16,000				149,540
QSUT	3,553,900	585,000	3,500,000	850,000			8,488,900
SUOGJ "MBRETËRESHA GER	434,800	69,000	300,000	30,000			833,800
SUOGJ "KOÇO GLIOZHENI"	343,500	55,190	300,000	34,000			732,690
QSR "SHEFQET NDROQI"	712,700	117,000	502,000	70,000			1,401,700
SU TRAUMA	196,800	31,000	350,000	60,000			637,800
TROPOJË	147,560	24,270	40,000				211,830
VLORË	579,450	95,330	360,000	72,000			1,106,780
"MEMORIAL" FIER					780,000		780,000
DURRËS				77,000	1,250,000		1,327,000
Paketat e shërbimeve					3,389,413		3,389,413
Transferta për individët (mjekë specialistë)					15,000		15,000
Trajtime me VKM					20,000		20,000
Pagesat e shërbimeve PPP					2,860,000		2,860,000
rezerve				14,000		493,007	507,007
	13,420,590	**2,191,780**	**7,956,100**	**1,900,000**	**8,314,413**	**493,007**	**34,275,890**

SHTOJCA NR. 3
LISTA E INSTITUCIONEVE, QË NUK DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

1. Spitali Psikiatrik Vlorë;
2. Spitali Psikiatrik Elbasan;
3. Shërbimet e shëndetit mendor në rrethe;
4. Shërbimi i psikiatrisë Shkodër;
5. Qendra Kombëtare e Riaftësimit, Mirërritjes dhe Zhvillimit të Fëmijëve;
6. Shërbimi Kombëtar i Transfuzionit;
7. Qendra Kombëtare Biomjekësore.

VENDIM
Nr. 16, datë 9.1.2025

PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT PËR VITIN 2025, NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE, PJESË TË SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2025 është gjithsej 1186, të ndara sipas kategorive të mëposhtme:

a) Për Trupën e Nëpunësve Civilë të Nivelit të Lartë Drejtues 5;
b) Për kategorinë e mesme drejtuese 93;
c) Për kategorinë e ulët drejtuese 283;
ç) Për kategorinë ekzekutive 805.

2. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm në kategorinë ekzekutive janë, si më poshtë vijon:

- Shkenca juridike;
- Audit i brendshëm;
- Shkenca ekonomike;
- Shkenca ekonomike/juridike;
- Shkenca shoqërore;
- Shkenca sociale;
- Histori-filologji;
- Shkenca mjekësore;
- Veterinari;
- Agronomi;
- Zootekni;
- Mbrojtje bimësh;
- Shkenca biologjike dhe të ngjashme me to;
- Kimi;
- Shkenca mjedisore ose të tjera të përshtatshme;
- Shkenca inxhinierike;
- Arkitekturë;
- Arkeologji dhe restaurime;
- Artet e bukura;
- Gjeodezi;
- Shkenca ekzakte;
- Shkenca edukimi;
- Mësuesi;
- Arsim i lartë ushtarak/policor;
- Arsim i lartë.

3. Institucionet e administratës shtetërore, ku planifikohen vendet vakante gjatë vitit 2025, janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Fondet buxhetore për vendet vakante të planifikuara për rekrutim për vitin 2025 janë pjesë e fondeve buxhetore, të miratuara me ligjin e buxhetit për vitin 2025 për secilin institucion të administratës shtetërore.

5. Plotësimi i vendeve vakante në kategorinë ekzekutive, gjithsej 805, në kategorinë e ulët drejtuese, gjithsej 283, apo kategorinë e mesme drejtuese, gjithsej 93, bëhet së pari nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ku mund të konkurrojnë nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në të njëjtin institucion apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele dhe kërkesat e posaçme për vendin/vendet e lira.

6. Vendet që mbeten të lira në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele:

a) për kategorinë ekzekutive plotësohen nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil, ku mund të konkurrojnë të gjithë ata kandidatë jashtë shërbimit civil që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme, të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit;

b) për kategorinë e ulët dhe atë të mesme drejtuese plotësohen nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, ku mund të konkurrojnë nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin institucion apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, nëse plotësojnë

kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira.

7. Plotësimi i vendeve vakante në Trupën e Nëpunësve Civilë të Nivelit të Lartë Drejtues bëhet sipas përcaktimeve në nenet 27–30, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

8. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

Lista e institucioneve të administratës shtetërore ku planifikohen vendet vakante gjatë vitit 2025

1. Kryeministria dhe institucionet në varësi të saj;
2. Sistemi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
3. Sistemi i Ministrisë së Brendshme;
4. Sistemi i Ministrisë së Mbrojtjes;
5. Sistemi i Ministrisë së Financave;
6. Sistemi i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;
7. Sistemi i Ministrisë së Drejtësisë;
8. Sistemi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
9. Sistemi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
10. Sistemi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
11. Sistemi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
12. Sistemi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

URDHËR
Nr. 181, datë 6.8.2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 193, DATË 6.10.2022, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE TË PËRBASHKËTA PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË MENAXHIMIT TË TRAFIKUT AJROR DHE TË LUNDRIMIT AJROR, SI DHE FUNKSIONET E TJERA TË RRJETIT TË MENAXHIMIT TË TRAFIKUT AJROR DHE MBIKËQYRJEN E TYRE"[1]

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të pikës 6, të nenit 84, të ligjit nr. 96/2020, "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë"; dhe në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil",

URDHËROJ:

1. Në rregulloren "Për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre", miratuar me urdhrin nr. 193, datë 6.10.2022, bëhen shtesat dhe ndryshimet sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Autoriteti i Aviacionit Civil dhe Ofruesit e Shërbimeve të Lundrimit Ajror për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

[1] Ky urdhër përafron plotësisht rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2023/1771, të datës 12 shtator 2023, që ndryshon rregulloren zbatuese (BE) 2017/373, për sa u përket sistemeve dhe përbërësve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror dhe që shfuqizon rregulloret (KE) nr. 1032/2006, (KE) nr. 633/2007 dhe (KE) nr. 262/2009, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së nr. 228, 15.9.2023.

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË RREGULLOREN "MBI PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE TË PËRBASHKËTA PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË MENAXHIMIT TË TRAFIKUT AJROR DHE TË LUNDRIMIT AJROR, SI DHE FUNKSIONET E TJERA TË RRJETIT TË MENAXHIMIT TË TRAFIKUT AJROR DHE MBIKËQYRJEN E TYRE"

1. Në Nenin 2 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

a) pika 3 zëvendësohet me sa vijon:

"3. "Menaxheri i rrjetit" nënkupton subjektin të cilit i janë besuar detyrat e nevojshme për zbatimin e funksioneve të përmendura në nenin 6 të udhëzimit të ministrit nr. 7, datë 3.6.2010, "Mbi organizimin dhe përdorimin e hapësirës ajrore brenda Qiellit të Vetëm Evropian", të ndryshuar;".

b) shtohen pikat 9, 10, 11, 12 dhe 13, si vijon:

"9) "Interogatori Mode S *(Mode S interogator)"* është një sistem, i përbërë nga antenë dhe pjesët elektronike, i cili mbështet adresimin e avionëve individualë nëpërmjet zgjedhjes së modalitetit ("Mode S");

10) "Interogatori Mode S i përshtatshëm *(eligible Mode S interrogator)"* nënkupton një interogator në Mode S për të cilin plotësohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) interogatori mbështetet, të paktën pjesërisht në pyetjet Mode S të të gjitha thirrjeve, dhe përgjigjet për arritjen e objektivave të Mode S;

b) interogatori veçon objektivat e Mode S në përgjigje të pyetjeve Mode S të të gjitha thirrjeve, në mënyrë të përhershme ose me ndërprerje, pjesërisht ose në tërësinë e mbulimit të tij; ose

c) interogatori përdor protokollet e komunikimeve në shumë faqe për aplikacionet e lidhjes së të të dhënave;

11) "Operator Mode S" nënkupton një person, organizatë ose ndërmarrje që operon ose ofron të operojë një interogator Mode S, duke përfshirë:

a) ofruesit e shërbimeve të survejimit;

b) prodhuesit e interogatorëve Mode S;

c) operatorët e aeroportit;

d) institucionet kërkimore;

e) çdo subjekt tjetër që ka të drejtë të operojë një interogator Mode S;

12) "Ndërhyrje e dëmshme" nënkupton ndërhyrje që pengon arritjen e kërkesave të performancës;

13) "Plani i shpërndarjes së kodit të interogatorit" nënkupton setin e plotë të aprovuar më së fundi të shpërndarjeve të kodit të interogatorit;".

2. Në nenin 3, shtohet paragrafi 6a, si më poshtë vijon:

"6a. Autoriteti i Aviacionit Civil siguron që përdorimi i një transmetuesi me bazë tokësore që operohet në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk prodhon ndërhyrje të dëmshme në sistemet e tjera të mbikëqyrjes.".

3. Pas nenit 3 shtohen nenet 3e dhe 3f me këtë përmbajtje:

Neni 3e
Shpërndarja e kodeve të interogatorit Mode S

1. Autoriteti i Aviacionit Civil siguron që ndryshimet në shpërndarjen e kodeve të një interogatori që rezultojnë nga një përditësim i planit të shpërndarjes së kodeve të interogatorit u komunikohen operatorëve përkatës të Mode S nën autoritetin e tij, brenda 14 ditëve kalendarike nga dita e marrjes së planit të përditësuar të shpërndarjes së kodeve.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil do të vërë në dispozicion të shteteve të tjera të ZPEA-së, të paktën çdo 6 muaj nëpërmjet sistemit të shpërndarjes së kodeve të interogatorit, një regjistër të përditësuar të shpërndarjes dhe përdorimit të kodeve të interogatorit të Mode S brenda zonës së tyre të përgjegjësisë.

3. Kur ekziston një mbivendosje ndërmjet mbulimit të një interogatori Mode S që ndodhet brenda zonës së përgjegjësisë të Republikës së Shqipërisë dhe mbulimit të një interogatori të Mode S që ndodhet brenda zonës së përgjegjësisë së një vendi tjetër, nga Autoriteti i Aviacionit Civil do të sigurohet që:

a) vendi tjetër të jetë i informuar për kërkesat e sigurisë në lidhje me shpërndarjen dhe përdorimin e kodeve të interogatorit;

b) të merren masat e nevojshme për të koordinuar përdorimin e kodeve të interogatorit me vendin tjetër në fjalë.

4. Autoriteti i Aviacionit Civil do të njoftojë ofruesit e shërbimeve të trafikut ajror nën

juridiksionin e tij për interogatorët Mode S që operojnë nën përgjegjësinë e një vendi tjetër për të cilin shpërndarja e kodeve të interogatorit Mode S nuk është koordinuar.

5. Autoriteti i Aviacionit Civil do të mundësojë një shërbim qendror të alokimit të kodeve të interogatorit. Autoriteti i Aviacionit Civil do të kontrollojë vlefshmërinë e aplikimeve të kodit të interogatorit të marrë nga operatorët e Mode S përpara se të vërë në dispozicion kodet e interogatorit përmes sistemit të shpërndarjes së kodeve të interogatorit për koordinim.

6. Autoriteti i Aviacionit Civil do të sigurohet që operatorët e Mode S, përveç ofruesve të shërbimeve të mbikëqyrjes, të jenë në përputhje me pikën CNS.TR.205 në shtojcën VIII.

7. Kërkesat e përcaktuara në paragrafët 1 deri në 6 nuk do të zbatohen në hapësirën ajrore të Qiellit të Vetëm Evropian që nuk është pjesë e rajonit evropian (EUR) të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO).

Neni 3f

Përdorimi i hapësirës ajrore të qiellit të vetëm evropian

1. Në kontekstin e mbrojtjes së spektrit, Autoriteti i Aviacionit Civil sigurohet që një transponder radari i mbikëqyrjes sekondare, në bordin e çdo avioni që fluturon mbi një shtet të ZPEA-së sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, nuk është subjekt i interogimeve të tepërta që transmetohen nga interogatorët e mbikëqyrjes me bazë tokësore dhe që ose nxjerrin përgjigje, ose edhe kur nuk nxjerrin një përgjigje, kanë fuqi të mjaftueshme për të tejkaluar nivelin minimal të pragut të marrësit të transponderit të radarit të mbikëqyrjes sekondare. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet shteteve të ZPEA-së, në lidhje me masat e nevojshme, AAC, kur Shqipëria është shtet i interesuar e çon çështjen në Komision.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil merr masa që të sigurohet që për Shqipërinë të gjitha caktimet e frekuencës së zërit të konvertohen në një hapësirë kanali 8,33 kHz.

Kërkesat e konvertimit nuk do të zbatohen për caktimet e frekuencës:

a) të cilat do të mbetet brenda hapësirës së kanaleve 25 kHz në frekuencat e mëposhtme:

1) frekuenca e emergjencës (121,5 MHz);

2) frekuencën ndihmëse për operacionet e kërkim-shpëtimit (123,1 MHz);

3) frekuencat e lidhjes digjitale VHF (VDL) të caktuara për t'u përdorur brenda hapësirës ajrore të qiellit të vetëm evropian;

4) frekuencat e sistemit të adresimit dhe raportimit të komunikimit të avionit (ACARS) (131,525 MHz, 131,725 MHz dhe 131,825 MHz);

b) ku përdoret funksionimi i bartësit të zhvendosur brenda një gjerësie kanali prej 25 kHz.

3. Kërkesat e përcaktuara në paragrafin 2 nuk do të zbatohen as në hapësirën ajrore të Qiellit të Vetëm Evropian, që nuk është pjesë e Rajonit EUR ICAO dhe as në Rajonin e Informacionit të Fluturimit Canarias (FIR)/Rajonin e Informacionit të Epërm (UIR).

4. Autoriteti i Aviacionit Civil do të vendosë dhe publikojë në publikimin kombëtar të informacionit aeronautik (AIP) aty ku është e zbatueshme, procedurat për trajtimin e avionëve që nuk janë të pajisur me:

a) transponderët e radarit të survejimit sekondar Mode S;

b) radiot që kanë aftësinë e ndarjes së kanaleve 8,33 kHz.".

4. Në anekset I, II, III, IV, VIII, IX, X dhe XII bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1) Në aneksin I bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

a) shtohet pika (30a) me këtë përmbajtje:

"(30a) "Pajisje ATM/ANS" nënkupton përbërësit e ATM/ANS siç përcaktohet në nenin 3(19) të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", dhe sistemet ATM/ANS, siç përkufizohen në nenin 3(23) të atij vendimi, duke përjashtuar përbërësit ajrorë, të cilët i nënshtrohen urdhrit të ministrit nr. 57, datë 13.3.2024, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor ose deklaratën e përputhshmërisë së avionit dhe produkteve të lidhura me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për kërkesat e aftësisë së organizatave të projektimit dhe prodhimit;";

b) shtohet pika (34a) me këtë përmbajtje:

"(34a) "kufi" nënkupton një plan anësor ose vertikal që përcakton hapësirën ajrore në të cilën një njësi ATC ofron shërbime të trafikut ajror;";

c) shtohen pikat (39a) dhe (39b) me këtë përmbajtje:

(39a) "të dhëna koordinimi" nënkupton të dhëna me interes për stafin operacional, në lidhje me procesin e njoftimit, koordinimit dhe transferimit të fluturimeve dhe me procesin e koordinimit civilo-ushtarak;

(39b) "pika e koordinimit" (COP) nënkupton një pikë në ose ngjitur me kufirin e përdorur nga njësitë ATC dhe referuar në proceset e koordinimit;";

d) shtohet pika (40a) me këtë përmbajtje:

"(40a) "shërbim i lidhjes së të dhënave" nënkupton një grup transaksionesh të lidhura me menaxhimin e trafikut ajror, të mbështetur nga komunikimet e lidhjeve të të dhënave ajrore-tokësore, të cilat kanë një qëllim operacional të përcaktuar qartë dhe fillojnë dhe mbarojnë në një ngjarje operative;";

e) shtohet pika (46a) me këtë përmbajtje:

"(46a) "kodi interogues i përshtatshëm" nënkupton çdo kod midis kodeve II dhe kodeve SI, përveç:

a) Kodi II 0;

b) kodin/et e interoguesit të rezervuar për entitetet ushtarake, duke përfshirë organizatat ndërqeveritare dhe në veçanti menaxhimin dhe alokimin e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut;';

f) shtohet pika (47a) me këtë përmbajtje:

"(47a) "të dhëna përllogaritëse" nënkupton pikën e koordinimit, kohën e parashikuar të një avioni dhe nivelin e pritshëm të fluturimit të avionit në pikën e koordinimit;";

g) shtohet pika (62a) me këtë përmbajtje:

"(62a) "sekuenca e zbatimit" nënkupton sekuencën e kufizuar në kohë të zbatimit të alokimeve të kodit interogues me të cilën operatorët e Mode S duhet të pajtohen për të shmangur konfliktet e përkohshme të kodit të interoguesit;";

h) shtohet pika (73a) me këtë përmbajtje:

"(73a) "njësi e njoftuar" nënkupton njësinë ATC që ka marrë informacionin e njoftimit;";

i) shtohet pika (81a) me këtë përmbajtje:

"(81a) "njësi marrëse" nënkupton njësinë e kontrollit të trafikut ajror që merr të dhëna;";

j) pika (88) zëvendësohet me:

"(88) "Direktivë sigurie" nënkupton një dokument të lëshuar ose miratuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, i cili:

1) urdhëron veprimet që duhet të kryhen në një sistem funksional ose vendos kufizime në përdorimin e tij operacional për të rivendosur sigurinë, kur provat tregojnë se siguria në operim përndryshe mund të rrezikohet; ose

2) urdhëron veprimet që duhet të kryhen në pajisjet ATM/ANS që i nënshtrohen deklaratës së përputhshmërisë të lëshuar në përputhje me nenin 6 të rregullores që përcakton rregulla të detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve lundrimit ajror dhe përbërësve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror, kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e rregullores së deleguar të Komisionit (BE) nr. 2023/1768, për të adresuar një gjendje të pasigurisë në aviacion ose të pasigurisë në operim që është identifikuar, ose të dyja, dhe për të rivendosur performancën dhe ndërveprimit të asaj pajisje ATM/ANS, kur provat tregojnë se siguria në operim, siguria në aviacion, performanca ose ndërveprimi i asaj pajisjeje të veçantë mund të rrezikohet.".

k) shtohen pikat (107a) dhe (107b) me këtë përmbajtje:

"(107a) "pozicioni i punës" nënkupton mobiliet dhe pajisjet teknike në të cilat një anëtar i personelit të shërbimeve të trafikut ajror kryen detyrat që lidhen me punën e tyre;

(107b) "paralajmërim" nënkupton një mesazh që shfaqet në një pozicion pune kur procesi i automatizuar i koordinimit ka dështuar;".

2. Në Aneksin II bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

a) në pikën ATM/ANS.AR.A.020, pika (a) zëvendësohet me:

"a) Autoriteti i Aviacionit Civil, kur është e zbatueshme, njofton pa vonesë të panevojshme Agjencinë, në rast të ndonjë problemi të rëndësishëm me zbatimin e dispozitave përkatëse të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", dhe akteve nënligjore në zbatim të tij ose të udhëzimit nr. 5, datë 3.6.2010, "Kuadri rregullativ në qiellin e vetëm evropian", të udhëzimit nr. 6, datë 3.6.2010, "Mbi dispozitat e shërbimit të navigimit ajror në qiellin

e vetëm evropian", të udhëzimin nr. 7, datë 3.6.2010, "Mbi organizimin dhe përdorimin e hapësirës ajrore brenda qiellit të vetëm evropian", që përafrojnë përkatësisht rregulloret (KE) nr. 549/2004, (KE) nr. 550/2004 dhe (KE) nr. 551/2004 të zbatueshëm për ofruesit e shërbimeve.";

b) pika ATM/ANS.AR.A.030 zëvendësohet me:

"ATM/ANS.AR.A.030 Direktivat e sigurisë

a) Autoriteti i Aviacionit Civil do të lëshojë një direktivë të sigurisë në operim kur ka konstatuar ekzistencën e ndonjë prej rasteve të mëposhtëm:

1) një gjendje e pasigurt në një sistem funksional që kërkon veprim të menjëhershëm;

2) një gjendje e pasigurisë në aviacion, e pasigurisë në operim, funksionimi nën nivelin e duhur të performancës ose mosndërveprimi në pajisjen që është subjekt i deklaratës së pajtueshmërisë, në përputhje me nenin 6 të rregullores, që përcakton rregullat e detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror, kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e rregullores së deleguar të Komisionit (BE) nr. 2023/1768, dhe ky kusht ka të ngjarë të ekzistojë ose zhvillohet në pajisje të tjera ATM/ANS.

b) Direktiva e sigurisë do t'u përcillet ofruesve të ATM/ANS në fjalë dhe do të përmbajë, minimalisht, informacionin e mëposhtëm:

1) identifikimin e gjendjes së pasigurisë në operim;

2) identifikimin e sistemit funksional të prekur;

3) veprimet e kërkuara dhe arsyetimi i tyre;

4) afati kohor për kryerjen e veprimeve të kërkuara;

5) datën e hyrjes në fuqi të tij.

c) Nëse është e zbatueshme, Autoriteti i Aviacionit Civil i dërgon një kopje të direktivës së sigurisë Agjencisë dhe çdo autoriteti tjetër kompetent të interesuar brenda një muaji nga lëshimi i saj.

d) Autoriteti i Aviacionit Civil do të verifikojë përputhshmërinë e ofruesve të ATM/ANS me direktivat e sigurisë dhe me direktivat e pajisjeve ATM/ANS, sipas rastit.";

c) pika (a) e ATM/ANS.AR.C.005 zëvendësohet me:

"a) Brenda objektit të pikës ATM/ANS.AR.B.001(a)(1), Autoriteti i Aviacionit Civil vendos një proces për të verifikuar:

1) pajtueshmërinë e ofruesve të shërbimeve me kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në anekset III deri në XIII, dhe çdo kusht të zbatueshëm bashkëngjitur certifikatës përpara lëshimit të asaj certifikate. Certifikata lëshohet në përputhje me shtojcën 1 të këtij aneksi;

2) pajtueshmërinë me çdo detyrim lidhur me sigurinë në operim në aktin e dezignimit të nxjerrë në përputhje me nenin 8 të udhëzimit nr. 6, datë 3.6.2010, "Mbi dispozitat e shërbimit të navigimit ajror në qiellin e vetëm evropian", që përafron rregulloren (KE) nr. 550/2004;

3) pajtueshmërinë e vazhdueshme me kërkesat e zbatueshme të ofruesve të shërbimeve nën mbikëqyrjen e tij;

4) zbatimin e objektivave të sigurisë në operim, sigurisë në aviacion dhe ndërveprimit, kërkesat e zbatueshme dhe kushtet e tjera të identifikuara në deklaratën e pajtueshmërisë për pajisjet ATM/ANS; kufizimet dhe kushtet teknike dhe të performancës të identifikuara në certifikatat e pajisjeve ATM/ANS dhe/ose deklaratat e pajisjeve ATM/ANS; dhe masat e sigurisë në operim, duke përfshirë direktivat e pajisjeve ATM/ANS të mandatuara nga Agjencia, në përputhje me pikën ATM/ANS.EQMT.AR.A.030 të shtojcës I të rregullores që përcakton rregullat e detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror, kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e rregullores së deleguar të Komisionit (BE) nr. 2023/1768, të cilat mund të pranohen dhe publikohen nga AAC;

5) zbatimin e direktivave të sigurisë në operim, veprimet korrigjuese dhe masat shtënguese.";

d) pika ATM/ANS.AR.C.050 ndryshohet si më poshtë:

i. pikat (c), (d) (e) dhe (f) zëvendësohen me:

"c) Një gjetje e nivelit 1 do të lëshohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil, kur zbulohet ndonjë mospërputhshmëri serioze me kërkesat e zbatueshme të vendimit të Këshillit të Ministrave

nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", dhe akteve nënligjore në zbatim të tij ose të udhëzimit nr. 5, datë 3.6.2010, "Kuadri rregullativ në qiellin e vetëm evropian", të udhëzimit nr. 6, datë 3.6.2010, "Mbi dispozitat e shërbimit të navigimit ajror në qiellin e vetëm evropian", të udhëzimin nr. 7, datë 3.6.2010, "Mbi organizimin dhe përdorimin e hapësirës ajrore brenda qiellit të vetëm evropian", që përafrojnë përkatësisht rregulloret (KE) nr. 549/2004, (KE) nr. 550/2004 dhe (KE) nr. 551/2004 dhe rregullat e tyre zbatuese, me procedurat dhe manualet e ofruesit të ATM/ANS, me termat dhe kushtet e certifikatës, me aktin e dezignimit, nëse është e zbatueshme, ose me përmbajtjen e një deklarate, e cila paraqet një rrezik të konsiderueshëm për sigurinë e fluturimit ose përndryshe vë në pikëpyetje aftësinë e ofruesit të shërbimit për të vazhduar operimet.

Gjetjet e nivelit 1 përfshijnë, por nuk kufizohen në:

1) nxjerrja e procedurave operacionale dhe/ose ofrimi i një shërbimi në një mënyrë që paraqet një rrezik të konsiderueshëm për sigurinë e fluturimit;

2) marrjen ose ruajtjen e vlefshmërisë së certifikatës së ofruesit të shërbimit nëpërmjet paraqitjes së provave dokumentare të falsifikuara;

3) dëshmi për keqpërdorim ose përdorim mashtrues të certifikatës së ofruesit të shërbimit;

4) mungesa e një menaxheri përgjegjës.

d) Një gjetje e nivelit 2 do të lëshohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil kur zbulohet ndonjë mospërputhshmëri tjetër me kërkesat e zbatueshme të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", dhe akteve nënligjore në zbatim të tij ose të udhëzimit nr. 5, datë 3.6.2010, "Kuadri rregullativ në qiellin e vetëm evropian", të udhëzimit nr. 6, datë 3.6.2010, "Mbi dispozitat e shërbimit të navigimit ajror në qiellin e vetëm evropian", të udhëzimin nr. 7, datë 3.6.2010, 'Mbi organizimin dhe përdorimin e hapësirës ajrore brenda qiellit të vetëm evropian"', që përafrojnë përkatësisht rregulloret (KE) nr. 549/2004, (KE) nr. 550/2004 dhe (KE) nr. 551/2004 dhe rregullat e tyre zbatuese, me procedurat dhe manualet e ofruesit të ATM/ANS ose me termat dhe kushtet e certifikatës, ose me përmbajtjen e deklaratës.

e) Kur zbulohet një gjetje, gjatë mbikëqyrjes ose me ndonjë mjet tjetër, Autoriteti i Aviacionit Civil, pa paragjykuar ndonjë veprim shtesë të kërkuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", dhe akteve nënligjore në zbatim të tij ose udhëzimi nr. 5, datë 3.6.2010, "Kuadri rregullativ në qiellin e vetëm evropian", udhëzimi nr. 6, datë 3.6.2010 "Mbi dispozitat e shërbimit të navigimit ajror në qiellin e vetëm evropian", udhëzimi nr. 7, datë 3.6.2010, 'Mbi organizimin dhe përdorimin e hapësirës ajrore brenda qiellit të vetëm evropian"', që përafrojnë përkatësisht rregulloret (KE) nr. 549/2004, (KE) nr. 550/2004 dhe (KE) nr. 551/2004 dhe rregullat e tyre zbatuese, ia komunikon gjetjen ofruesit të shërbimit me shkrim dhe kërkon veprime korrigjuese për të adresuar mospërputhshmërinë/të e identifikuara:

1) Në rastin e gjetjeve të nivelit 1, Autoriteti i Aviacionit Civil do të ndërmarrë veprime të menjëhershme dhe të duhura dhe, nëse është e përshtatshme, mund të kufizojë, pezullojë ose revokojë plotësisht ose pjesërisht certifikatën duke siguruar vazhdimësinë e shërbimeve me kusht që siguria në operim të mos jetë kompromotuar, dhe kur është e zbatueshme në rastin e Menaxherit të Rrjetit, ai do të informojë Komisionin. Masat e marra do të varen nga shtrirja e gjetjes dhe do të mbeten në fuqi derisa të ndërmerren veprime korrigjuese të suksesshme nga ofruesi i ATM-së/ANS.

2) Në rastin e gjetjeve të nivelit 2, Autoriteti i Aviacionit Civil:

i. i jep ofruesit të shërbimit një periudhë zbatimi të veprimeve korrigjuese të përfshira në një plan veprimi të përshtatshëm për natyrën e gjetjes;

ii. vlerëson veprimet korrigjuese dhe planin e zbatimit të propozuar nga ofruesi i shërbimit dhe, nëse vlerësimi arrin në përfundimin se ato janë të mjaftueshme për të adresuar mospërputhshmërinë /të, i pranon ato.

3) Në rastin e gjetjeve të nivelit 2, kur ofruesi i shërbimit dështon të paraqesë një plan veprimi korrigjues që është i pranueshëm për Autoritetin e Aviacionit Civil në këndvështrimin e gjetjes, ose kur ofruesi i shërbimit nuk arrin të kryejë veprimin korrigjues brenda periudhës së kohës së pranuar ose zgjatur nga Autoriteti i Aviacionit Civil, gjetja

mund të ngrihet në një gjetje të nivelit 1 dhe në këtë rast do të ndërmerren veprime siç parashikohet në pikën 1.

f) Kur Autoriteti i Aviacionit Civil zbulon se ofruesi i ATM/ANS integron pajisjet ATM/ANS në sistemin e tij funksional pa siguruar përputhjen me pikën ATM/ANS.OR.A.045(g), ai, duke pasur parasysh nevojën për të garantuar sigurinë në operim dhe vazhdimësinë e operimeve, merr të gjitha masat e nevojshme për të kufizuar zonën e aplikimit të pajisjes ATM/ANS në fjalë ose për të ndaluar përdorimin e saj nga ofruesit e ATM/ANS nën mbikëqyrjen e tij.";

ii. shtohet pika (g) me këtë përmbajtje:

"g) Për ato raste që nuk kërkojnë gjetje të nivelit 1 dhe 2, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të nxjerrë observacione.";

3. Në aneksin III bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

a) në pikën ATM/ANS.OR.A.045 shtohen pikat (g) deri në (j), të cilat do të zbatohen kur rregullorja që përcakton rregullat e detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror, që përafron rregulloren e deleguar (BE) nr. 2023/1768, dhe rregullorja që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative për miratimin e organizatave të përfshira në projektimin dhe prodhimin e sistemeve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror, që përafron rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) nr. 2023/1769 të kenë hyrë në fuqi, me këtë përmbajtje:

"g) Përpara se të integrojë pajisjet ATM/ANS në sistemin funksional, ofruesi i ATM/ANS duhet të sigurojë që:

1) pajisjet e reja ose të modifikuara ATM/ANS janë të certifikuara nga Agjencia në përputhje me rregulloren që përcakton rregullat e detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror, që përafron rregulloren e deleguar (BE) nr. 2023/1768, dhe janë prodhuar nga një organizatë e miratuar projektimi ose prodhimi në përputhje me rregulloren që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative për miratimin e organizatave të përfshira në projektimin dhe prodhimin e sistemeve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror, që përafron rregulloren zbatuese (BE) nr. 2023/1769; ose

2) pajisjet e reja ose të modifikuara ATM/ANS deklarohen nga një organizatë projektuese e miratuar në përputhje me rregulloren që përcakton rregullat e detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror që përafron rregulloren e deleguar (BE) nr. 2023/1768 dhe janë prodhuar nga një organizatë e miratuar projektimi ose prodhimi në përputhje me rregulloren që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative për miratimin e organizatave të përfshira në projektimin dhe prodhimin e sistemeve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror që përafron rregulloren zbatuese (BE) nr. 2023/1769; ose

3) pajisjet e reja ose të modifikuara ATM/ANS lëshohen me një deklaratë përputhshmërie në përputhje me nenin 6(1) të rregullores që përcakton rregullat e detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror që përafron rregulloren e deleguar (BE) nr. 2023/1768; ose

4) kur pajisja ATM/ANS nuk është subjekt i vlerësimit të konformitetit sipas rregullores që përcakton rregullat e detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror që përafron rregulloren e deleguar (BE) nr. 2023/1768, pajisja e veçantë ATM/ANS

është verifikuar për përputhje me specifikimet dhe kualifikimet e zbatueshme;

h) ofruesi i ATM/ANS duhet të sigurojë që pajisja ATM/ANS është verifikuar në përputhje me specifikimet e prodhuesit të pajisjeve, duke përfshirë instalimin dhe testin/et në vend.

i) përpara se ofruesi i ATM/ANS të vërë në shërbim pajisjen ATM/ANS, ai duhet të sigurojë që sistemi funksional i modifikuar që integron këtë pajisje ATM/ANS plotëson të gjitha kërkesat e zbatueshme dhe do të identifikojë të gjitha devijimet dhe kufizimet.

j) kur ofruesi i ATM/ANS vë në shërbim pajisjen ATM/ANS, ai duhet të sigurojë që pajisja ATM/ANS, ose ajo e modifikuar, të vendoset në përputhje me kushtet e përdorimit, si dhe me çdo kufizim të zbatueshëm, dhe plotëson të gjitha kërkesat e zbatueshme.".

b) pika ATM/ANS.OR.A.060 zëvendësohet me:

"ATM/ANS.OR.A.060 Reagim i menjëhershëm ndaj një problemi sigurie

a) Një ofrues shërbimi do të zbatojë çdo masë sigurie, duke përfshirë direktivat e sigurisë, të mandatuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil në përputhje me pikën ATM/ANS.AR.A.025(c).

Kur të lëshohet një direktivë sigurie për të korrigjuar gjendjen e përmendur në deklaratën e pajtueshmërisë të lëshuar në përputhje me nenin 6 të rregullores që përcakton rregullat e detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror, kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e rregullores së deleguar (EU) 2023/1768, ofruesi i ATM/ANS, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga Autoriteti i Aviacionit Civil, në rastin kur nevojiten veprime urgjente:

1) propozon veprimet e duhura korrigjuese dhe i dorëzon detajet e atij propozimi Autoritetit të Aviacionit Civil për miratim;

2) pas miratimit nga Autoriteti i Aviacionit Civil, i zbaton ato.";

c) në pikën (a) të ATM/ANS.OR.B.005, shtohet pika (8) me këtë përmbajtje:

"8) një proces për të siguruar që dizajni i pajisjeve ATM/ANS, ose ndryshimet në dizajnin e tij, që i nënshtrohet nenit 6 të rregullores që përcakton rregullat e detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/të shërbimeve të lundrimit ajror, kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e rregullores së deleguar (BE) nr. 2023/1768, në përputhje me specifikimet e zbatueshme, duke përfshirë funksionin e pavarur të kontrollit të demonstrimit të pajtueshmërisë në bazë të së cilës ofruesi i ATM/ANS lëshon një deklaratë përputhshmërie dhe dokumentacionin përkatës të pajtueshmërisë me të.";

d) ATM/ANS.OR.D.025 ndryshohet, si më poshtë:

"1. Pika (c) zëvendësohet me:

"c) Menaxheri i Rrjetit i jep Komisionit dhe Agjencisë një raport vjetor të aktiviteteve të tij. Ky raport do të mbulojë performancën e tij operative, si dhe aktivitetet dhe zhvillimet e rëndësishme në veçanti në fushën e sigurisë.';

2. Pika (d)(3) zëvendësohet me:

"3. për Menaxherin e Rrjetit, performancën e tij krahasuar me objektivat e performancës të përcaktuara në Planin e Strategjisë së Rrjetit, duke krahasuar performancën aktuale me performancën e përcaktuar në Planin Operativ të Rrjetit, duke përdorur treguesit e performancës të vendosur në Planin Operativ të Rrjetit;".

4. Në aneksin IV bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

a) pika ATS.OR.400 zëvendësohet me:

"**ATS.OR.400 Shërbim aeronautik "*mobile*" (komunikim ajër-tokë) – i përgjithshëm**

a) Një ofrues i shërbimeve të trafikut ajror do të përdorë lidhjen zanore ose të të dhënave, ose të dyja, në komunikimet ajër-tokë për qëllime të shërbimeve të trafikut ajror.

b) Kur komunikimet zanore ajër-tokë bazohen në hapësirën e kanaleve 8,33 kHz, një ofrues i shërbimeve të trafikut ajror duhet të sigurojë që:

1) të gjitha pajisjet për komunikimet zanore ajër-tokë përfshijnë aftësinë e ndarjes së kanaleve 8,33 kHz dhe janë në gjendje të sintonizojnë kanalet me distancë 25 kHz;

2) të gjitha caktimet e frekuencës së zërit kanë aftësinë e ndarjes së kanaleve 8,33 kHz;

3) procedurat e zbatueshme për avionët e pajisur me radio që kanë aftësinë e ndarjes së

kanaleve 8,33 kHz dhe për avionët që nuk janë të pajisur me pajisje të tilla, që i nënshtrohen transferimit ndërmjet njësive të shërbimeve të trafikut ajror, janë të specifikuara në letrat e marrëveshjes ndërmjet atyre njësive të ATS;

4) avionët që nuk janë të pajisur me radio që kanë aftësinë e ndarjes së kanaleve 8,33 kHz mund të akomodohen, me kusht që të mund të trajtohen në mënyrë të sigurt brenda kufijve të kapacitetit të sistemit të menaxhimit të trafikut ajror në UHF ose në caktimet e frekuencës 25 kHz; dhe

5) ai i komunikon, në baza vjetore, Autoritetit të Aviacionit civil që e ka caktuar, planet e tij për trajtimin e avionëve shtetërorë të cilët nuk janë të pajisur me radio që kanë aftësinë e ndarjes së kanaleve 8,33 kHz, duke marrë parasysh kufijtë e kapacitetit të lidhur me procedurat e publikuara në publikimet kombëtare të informacionit aeronautik (AIP).

c) Kur, për ofrimin e shërbimit të kontrollit të trafikut ajror, përdoren komunikimet zanore e drejtpërdrejta pilot-kontrollor, me dy drejtime ose *Data Link,* pajisjet e regjistrimit duhet të sigurohen nga ofruesi i shërbimeve të trafikut ajror në të gjitha kanalet e tilla të komunikimit ajër-tokë.

d) Kur për ofrimin e shërbimit të informacionit të fluturimit, duke përfshirë shërbimin e informacionit të fluturimit të aeroportit (AFIS), përdoren komunikime të drejtpërdrejta zanore me dy drejtime ose lidhje të të dhënave ajër-tokë, pajisjet e regjistrimit në të gjitha kanalet e tilla të komunikimit ajër-tokë do të sigurohen nga ofruesi i shërbimeve të trafikut ajror, përveç nëse parashikohet ndryshe nga Autoriteti i Aviacionit Civil.";

b) pika ATS.OR.415 zëvendësohet me:

"ATS.OR.415 Shërbimi aeronautik "*mobile*" (komunikimet ajër-tokë) – shërbimi i kontrollit të zonës

Një ofrues i shërbimeve të trafikut ajror duhet të sigurojë që:

a) pajisjet e komunikimit ajër-tokë mundësojnë që komunikimet zanore në dy drejtime të kryhen ndërmjet një njësie që ofron shërbimin e kontrollit të zonës dhe avionëve të pajisur siç duhet, që fluturojnë kudo brenda zonës ose zonave të kontrollit; dhe

b) objektet e komunikimit ajër-tokë mundësojnë komunikimin në dy drejtime të të dhënave ndërmjet një njësie që ofron shërbimin e kontrollit të zonës dhe avionëve të pajisur siç duhet që fluturojnë brenda hapësirës ajrore të përmendur në pikën AUR.COM.2001 të rregullores që përcakton dispozitat për pajisjet e avionëve, të kërkuara për përdorimin e hapësirës ajrore të qiellit të vetëm evropian dhe rregullat e funksionimit në lidhje me përdorimin e hapësirës ajrore të vetme evropiane, kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e rregullores zbatuese të Komisionit (BE) nr. 2023/1770, për të përdorur shërbimet e lidhjes së të dhënave të referuara në pikën (1) (a) të pikës AUR.COM.2005 të asaj rregulloreje zbatuese.";

c) pika ATS.OR.430 zëvendësohet me:

"ATS.OR.430 Shërbimi fiks aeronautik (komunikim tokë-tokë) – i përgjithshëm

a) Një ofrues i shërbimeve të trafikut ajror duhet të sigurojë që komunikimet e të folurit të drejtpërdrejtë ose të lidhjes së të dhënave, ose të dyja, përdoren në komunikimet tokë-tokë për qëllime të shërbimeve të trafikut ajror.

b) Kur komunikimi për qëllime të koordinimit ATC mbështetet nga automatizimi, një ofrues i shërbimeve të trafikut ajror duhet të sigurojë që:

1) janë zbatuar masat e duhura për të marrë, ruajtur, përpunuar, nxjerrë dhe shfaqur automatikisht informacionin përkatës të fluturimit;

2) dështimet ose anomalitë e një koordinimi të tillë të automatizuar i paraqiten qartë kontrollorit ose kontrollorëve të trafikut ajror përgjegjës për koordinimin e fluturimeve në një njësi transferuese;

3) paralajmërimet në lidhje me shkëmbimin e informacionit të sistemit paraqiten në pozicionet përkatëse të punës;

4) informacioni për proceset përkatëse të shkëmbimit të informacionit të sistemit u jepet kontrollorëve të trafikut ajror;

5) kontrollorët e trafikut ajror pajisen me mjetet për të modifikuar informacionin e shkëmbyer të fluturimit.";

d) shtohet pika ATS.OR.446 me këtë përmbajtje:

"ATS.OR.446 Të dhënat e survejimit

a) Ofruesit e shërbimeve të trafikut ajror nuk do të përdorin të dhëna nga interogatorët Mode S që operojnë nën përgjegjësinë e një vendi tjetër, nëse shpërndarja e kodit të interogatorit nuk është koordinuar.

b) Ofruesit e shërbimeve të trafikut ajror duhet të sigurojnë që aftësitë e nevojshme janë zbatuar për të lejuar kontrollorët e trafikut ajror të vendosin identifikimin individual të avionit, duke përdorur veçorinë e identifikimit të avionit të lidhur me linjë, siç detajohet në shtojcën 1.

c) Ofruesit e shërbimeve të trafikut ajror duhet të sigurojnë operime të pandërprera brenda hapësirës ajrore nën përgjegjësinë e tyre dhe në kufirin me hapësirat ajrore ngjitur duke zbatuar kërkesat minimale të përshtatshme për ndarjen e avionëve.";

e) në pikën ATS.TR.230, shtohet pika (c) me këtë përmbajtje:

"c) Koordinimi i transferimit të kontrollit ndërmjet njësive që ofrojnë shërbimin e kontrollit të zonës brenda rajonit EUR ICAO, ose kur është rënë dakord me ose ndërmjet njësive të tjera të kontrollit të trafikut ajror, do të mbështetet nga procese të automatizuara, siç përcaktohet në shtojcën 2.";

f) shtohen shtojcat e mëposhtme 1 dhe 2, me këtë përmbajtje:

"SHTOJCA 1

Identifikimi i avionit individual duke përdorur veçorinë e identifikimit të avionit me lidhje të poshtme, siç kërkohet nga pika ATS.OR.446(b)

Tipari i identifikimit të avionit me lidhje të poshtme do të përdoret si më poshtë për të vendosur identifikimin individual të avionit:

a) Ofruesi i shërbimeve të trafikut ajror do t'i deklarojë Menaxherit të Rrjetit vëllimet e hapësirës ajrore ku përcaktohet identifikimi individual i avionit duke përdorur veçorinë e identifikimit të avionit me lidhje të poshtme.

b) Kodi i dallimit SSR A1000 do t'i caktohet avionit ku identifikimi individual i avionit përcaktohet duke përdorur veçorinë e identifikimit të avionit me lidhje të poshtme.

c) Me përjashtim të rasteve kur zbatohet një nga kushtet e përcaktuara në pikën (d), kodi SSR i dallimit A1000 do t'i caktohet avionit që niset ose avionëve për të cilët, në përputhje me pikën (g), kërkohet një ndryshim kodi, kur zbatohen kushtet e mëposhtme:

1) identifikimi i avionit me lidhje të ulët përputhet me hyrjen përkatëse në planin e fluturimit për atë avion;

2) Menaxheri i rrjetit ka komunikuar se avioni i veçantë është i përshtatshëm për caktimin e kodit SSR të dallueshëm A1000.

d) Kodi SSR i dallueshëm A1000 nuk do t'u caktohet avionëve të përmendur në pikën (c) nëse zbatohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:

1) janë vendosur masat emergjente që kërkojnë caktimin e kodeve të dallueshme SSR për avionët nga një ofrues i shërbimit të navigimit ajror që përjeton ndërprerje të paplanifikuara të sensorit të mbikëqyrjes tokësore;

2) Masat e jashtëzakonshme të emergjencës ushtarake kërkojnë që ofruesit e shërbimeve të navigimit ajror të caktojnë kode të dallueshme SSR për avionët;

3) Një avion i cili është i përshtatshëm për caktimin e kodit SSR të dallueshëm A1000 të vendosur në përputhje me pikën (c) del ose devijohet ndryshe jashtë vëllimit të hapësirës ajrore të përmendur në pikën (a).

e) Avionëve të cilëve nuk u është caktuar kodi SSR i dukshëm A1000 i vendosur në përputhje me pikën (c) do t'u caktohet një kod SSR që përputhet me një listë të shpërndarjes së kodeve të rënë dakord dhe të koordinuar me vendet e tjera (përfshirë dhe vendet anëtare).

f) Kur një kod SSR i është caktuar një avioni, një kontroll do të bëhet sa më shpejt që të konfirmohet se kodi SSR i vendosur nga piloti është identik me atë të caktuar për fluturimin.

g) Kodet SSR të caktuara për avionët që transferohen nga ofruesit e shërbimeve të trafikut ajror në shtetet fqinje do të kontrollohen automatikisht për të parë nëse caktimet mund të mbahen në përputhje me një listë të shpërndarjes të kodeve të rënë dakord dhe të koordinuara me vendet e tjera.

h) Marrëveshjet formale me përmbajtjen minimale të mëposhtme do të vendosen me ofruesit fqinjë të shërbimeve të navigimit ajror që vendosin identifikimin individual të avionit duke përdorur kode diskrete SSR:

1) një detyrim për ofruesit fqinjë të shërbimeve të navigimit ajror për të transferuar avionë me kode diskrete të verifikuara SSR të caktuara në përputhje me një listë të shpërndarjes së kodeve të

rënë dakord nga Shtetet Anëtare dhe të koordinuar me vendet e treta;

2) një detyrim për të njoftuar njësitë pranuese për çdo parregullsi të vërejtur në funksionimin e përbërësve ajrore të sistemeve të mbikëqyrjes;

i) ofruesit e shërbimeve të trafikut ajror duhet të sigurojnë që caktimi i kodeve diskrete SSR në përputhje me një listë të shpërndarjes së kodeve të rënë dakord dhe të koordinuar me vendet e tjera për të vendosur identifikimin individual të avionit, përputhet me sa vijon:

1) kodet SSR u caktohen automatikisht avionëve në përputhje me një listë të shpërndarjes së kodeve të rënë dakord dhe të koordinuara me vendet e tjera;

2) kodet SSR të caktuara për avionët që transferohen nga ofruesit e shërbimeve të navigimit ajror në shtetet fqinje kontrollohen për të parë nëse caktimet mund të mbahen në përputhje me një listë të shpërndarjes së kodeve të rënë dakord nga Shtetet Anëtare dhe të koordinuara me vendet e treta;

3) kodet SSR klasifikohen në kategori të ndryshme për të lejuar caktimin e kodeve të diferencuara;

4) kodet SSR nga kategoritë e ndryshme të përmendura në pikën 3 janë caktuar sipas drejtimeve të fluturimeve;

5) caktime të shumta të njëkohshme të të njëjtit kod SSR u bëhen fluturimeve që operojnë në drejtime pa konflikt kodesh;

6) kontrollorët informohen automatikisht kur caktimet e kodit SSR dublikohen pa qëllim.

SHTOJCA 2

Proceset që do të zbatohen për koordinim të automatizuar siç kërkohet nga pika ATS.TR.230(c)

A. Proceset e detyrueshme që do të zbatohen ndërmjet njësive që ofrojnë shërbimin e kontrollit të zonës, ose kur është rënë dakord me ose ndërmjet njësive të tjera të kontrollit të trafikut ajror, do të jenë si më poshtë:

a) Njoftimi:

1) Informacioni i fluturimit që i nënshtrohet procesit të njoftimit duhet të përfshijë minimalisht:

i. identifikimin e avionit;

ii. modaliteti dhe kodi SSR (nëse disponohet);

iii. aeroportin e nisjes;

iv. të dhënat e vlerësimit;

v. aeroporti i destinacionit;

vi. numrin dhe llojin e avionit;

vii. lloji i fluturimit;

viii. aftësia dhe statusi i pajisjeve.

2) Përmbajtja e informacionit të "mundësisë dhe statusit të pajisjes" përfshin minimumin e reduktuar minimal të ndarjes vertikale (RVSM) dhe aftësinë për ndarjen e kanaleve 8,33 kHz. Artikuj të tjerë mund të përfshihen në përputhje me letrat e marrëveshjes.

3) Procesi i njoftimit do të kryhet të paktën një herë për çdo fluturim të përshtatshëm të planifikuar për të kaluar kufijtë, përveç nëse fluturimi është objekt i procesit të njoftimit dhe koordinimit para nisjes.

4) Kriteret e përshtatshmërisë për njoftimin ndërkufitar të fluturimeve duhet të jenë në përputhje me letrat e marrëveshjes.

5) Kur procesi i njoftimit nuk mund të kryhet në një kohë të dakorduar nga të dyja palët para procesit të koordinimit fillestar, ai përfshihet në procesin e koordinimit fillestar.

6) Kur kryhet, procesi i njoftimit i paraprin procesit të koordinimit fillestar.

7) Procesi i njoftimit do të përsëritet sa herë që ka një ndryshim në ndonjë nga të dhënat e mëposhtme përpara procesit të koordinimit fillestar:

i. pika e koordinimit (COP);

ii. kodin e pritur SSR në pikën e transferimit të kontrollit;

iii. aeroporti i destinacionit;

iv. lloji i avionit;

v. aftësia dhe statusi i pajisjeve.

8) Nëse konstatohet mospërputhje ndërmjet të dhënave të transmetuara dhe të dhënave përkatëse në sistemin pranues, ose nëse nuk ka informacion të tillë që do të rezultonte në nevojën për veprime korrigjuese pas marrjes së të dhënave fillestare të koordinimit, mospërputhja do të referohet në një pozicion të përshtatshëm pune kontrollori për zgjidhje.

9) Kriteret kohore për fillimin e procesit të njoftimit:

i. Procesi i njoftimit do të fillojë me një numër parametri minutash përpara kohës së parashikuar në COP (pikën e koordinimit).

ii. Parametrat e njoftimit do të përfshihen në letrat e marrëveshjes ndërmjet njësive ATC në fjalë.

iii. Parametrat e njoftimit mund të përcaktohen veçmas për secilën nga pikat e koordinimit.

b) Koordinimi fillestar:

1) Për një fluturim që i nënshtrohet koordinimit fillestar, kushtet e miratuara të transferimit të një fluturimi do të jenë operative detyruese për të dyja njësitë e kontrollit të trafikut ajror, përveç nëse koordinimi shfuqizohet ose rishikohet.

2) Informacioni për fluturimin që i nënshtrohet procesit të koordinimit fillestar duhet të përfshijë minimalisht:

i. identifikimin e avionit;

ii. modaliteti dhe kodi SSR;

iii. aeroporti i nisjes;

iv. të dhënat e vlerësuara;

v. aeroporti i destinacionit;

vi. numrin dhe llojin e avionit;

vii. lloji i fluturimit;

viii. aftësia dhe statusi i pajisjeve.

3) Përmbajtja e informacionit të "mundësisë dhe statusit të pajisjes" duhet të përfshijë si minimum aftësinë RVSM dhe ndarjen e kanaleve 8,33 kHz. Zëra të tjerë mund të përfshihen siç është rënë dakord në mënyrë dypalëshe nga letrat e marrëveshjes.

4) Procesi fillestar i koordinimit do të kryhet për të gjitha fluturimet e pranueshme të planifikuara për të kaluar kufijtë.

5) Kriteret e përshtatshmërisë për koordinimin fillestar ndërkufitar të fluturimeve do të jenë në përputhje me letrat e marrëveshjes.

6) Nëse nuk është nisur tashmë manualisht, procesi i koordinimit fillestar do të iniciohet automatikisht, në përputhje me letrat e marrëveshjes, në:

i. një periudhë kohore parametri të rënë dakord nga të dyja palët përpara kohës së parashikuar në pikën e koordinimit; ose

ii. koha në të cilën fluturimi është në një distancë të rënë dakord nga të dyja palët nga pika e koordinimit.

7) Procesi fillestar i koordinimit për fluturim kryhet vetëm një herë, përveç nëse fillon anulimi i procesit të koordinimit.

8) Pas shfuqizimit të procesit të koordinimit, procesi fillestar i koordinimit mund të fillohet sërish me të njëjtën njësi.

9) Përfundimi i procesit fillestar të koordinimit, duke përfshirë konfirmimin nga njësia pranuese, do t'i kalohet njësisë transferuese - atëherë fluturimi konsiderohet "i koordinuar".

10) Dështimi i procesit të koordinimit fillestar për të konfirmuar përfundimin, në përputhje me kërkesat e zbatueshme të cilësisë së shërbimit, do të rezultojë në një paralajmërim në pozicionin e punës së kontrollorit përgjegjës për koordinimin e fluturimit brenda njësisë transferuese.

Peloponnese, Western Greece and the Ionian Islands	West Greece*	Aktio-Vonitsa*
Thessaly and Central Greece	Thessaly*	Kalambaka*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu,

me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët.

b) Janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë serotipave të demonstruar të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë serotipave të demonstruar se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

c) Certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

ç) Certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8., 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose me nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

3. Certifikata veterinare shëndetësore të garantojë origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikës 1 dhe 2.

4. Urdhri nr. 979, datë 19.11.2024, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Greqisë", shfuqizohet.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit ruminantë të vegjël dhe spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i

Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 1153, datë 31.12.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË AFTËS EPIZOOTIKE TË SHFAQUR NË SHTETIN E TURQISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë:

a) gjithë kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra;

b) materialit biologjik dhe të pashoqëruara me test diagnostik PCR të rezultuar negativ i bashkëlidhur certifikata shëndetësore veterinare, të kryer 21 ditë para mbledhjes së tyre;

c) mishin e freskët;

d) produktet e mishit të patrajtuara me të paktën me një temperaturë prej 70°C për 30 minuta;

e) qumështin dhe produktet e qumështit të patrajtuara termikisht me një temperaturë minimale prej 72°C për 15 sekonda (temperaturë e lartë – kohë e shkurtër pasterizimi (HTST) e aplikuar 2 herë) ose çdo trajtim tjetër ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike;

f) leshit, qimeve, lëkurëve dhe lëkurëve të papërpunuara të patrajtuara ose papërpunuara ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike;

g) ushqim me përmbajtje proteinike dhe ushqimi i kafshëve ruminantë dhe derra të patrajtuara termikisht, ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike.

Sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të tabelës së mëposhtme të shtetit të Turqisë:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Sivas	Ulaş*	
Sivas	Akıncılar*	
Sivas	Yıldızeli*	
Sivas	Altınyayla*	
Sivas	Kangal*	
Sivas	Doğanşar*	
Sivas	Gürün*	
Sivas	Merkez*	
Sivas	İmranlı*	
Diyarbakir	Merkez*	
Konya	Kadınhanı*	
Konya	Ereğli*	
Tunceli	Pülümür*	
Tunceli	Pertek*	
Denizli	Çal*	
Denizli	Çivril*	
Erzurum	Şenkaya*	
Erzurum	Çat*	
Erzurum	Uzundere*	
Erzurum	Hınıs*	
Erzurum	Karaçoban*	
Erzurum	Aşkale*	
Erzurum	Tekman*	
Erzuru	Ilıca*	
Erzurum	İspir*	
Afyon	Sandıklı*	
Afyon	Dinar*	
Afyon	Bolvadin*	
Afyon	Sincanlı*	
Afyon	Sultandağı*	
Afyon	Merkez*	
Afyo	İhsaniye*	
Batman	Kozluk*	
Isparta	Yalvaç*	
Isparta	Keçiborlu*	
Isparta	Gönen*	
Isparta	Merkez*	
Isparta	Şarkikaraağaç*	
Izmir	Seferihisar*	
Izmir	Bayındır*	
Aydin	Germencik*	
Aydin	İncirliova*	
K. Maras	Elbistan*	
Burdur	Merkez*	
Burdur	Karamanlı*	
Burdur	Bucak*	
Aksaray	Eskil*	
Aksaray	Güzelyurt*	
Aksaray	Gülağaç*	
Aksaray	Merkez*	
Adana	Tufanbeyli*	
Adana	Karataş*	
Adana	Aladağ*	
Trabzon	Maçka*	
Rize	İkizdere*	
Kütahya	Simav*	
Kütahya	Aslanapa*	

Kütahya	Emet*	
Konya	Ilgın*	
Konya	Altınekin*	
Konya	Tuzlukçu*	
Konya	Derbent*	
Kirsehir	Akpınar*	
Kirsehir	Akçakent*	
Kirsehir	Merkez*	
Kayseri	Sarıoğlan*	
Kayseri	Yahyalı*	
Kayseri	Akkışla*	
Kayseri	Pınarbaşı*	
Erzincan	Otlukbeli*	
Erzincan	Üzümlü*	
Iğdır	Karakoyunlu*	
Bingöl	Yedisu*	
Erzincan	Çayırlı*	
Erzincan	Tercan*	
Erzincan	Otlukbeli*	
Erzincan	Merkez*	
Nevsehir	Kozaklı*	
Nevsehir	Gülşehir*	
Van	Erciş*	
Mus	Bulanık*	
Mus	Merkez*	
Mus	Varto*	
Malatya	Yazıhan*	
Malatya	Merkez*	
Mardin	Savur*	
Kars	Arpaçay*	
Kars	Merkez*	
Kars	Sarıkamış*	
Kars	Digor*	
Elazığ	Merkez*	
Elazığ	Karakoçan*	
Elazığ	Alacakaya*	
Elazığ	Kovancılar*	
Adiyaman	Gölbaşı*	
Adiyaman	Gerger*	
Nevsehir	Merkez*	
Eskisehir	İnönü*	
Eskisehir	Sivrihisar*	
Agri	Merkez*	
Agri	Tutak*	
Hakkari	Merkez*	
Siirt	Şirvan*	
Van	Gürpınar*	
Afyon	Dazkırı*	
Van	Merkez*	
Ankara	Bala*	
Sanliurfa	Ceylanpınar*	
Tunceli	Ovacık*	
Gaziantep	**Oğuzeli***	
Iğdır	**Merkez***	
Iğdır	**Aralık***	
Kütahya	**Tavşanlı***	

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra, materialit biologjik, embrioneve, mishin e freskët, produktet dhe nënprodukteve të tyre, qumështin, produktet e qumështit, mielli i mishit, mielli i gjakut, leshit, qimeve, lëkurëve dhe lëkurëve të trajtuara dhe të papërpunuara dhe ushqimit të kafshëve, të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra.

3. Urdhri nr. 983, datë 19.11.2024, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së aftës epizootike të shfaqur në shtetin e Turqisë", shfuqizohet.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 1154, datë 31.12.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE TË DHIVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E TURQISË"

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik, dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet

administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme.

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*
Adana	Kozan*
Adana	Aladağ*
Adana	**Karaisali***
Afyon	**Dazkırı***
Antalya	**Merkez***
Malatya	Arguvan*
Karaman	Merkez*
Izmir	Dikili*
Izmir	Çiğli*
Izmir	Ödemiş*
Izmir	Güzelbahçe*
Izmir	**Aliağa***
Kars	Kağızman*
Hakkari	Merkez*
Aydin	Sultanhisar*
Çankiri	Çerkeş*
Çankiri	Merkez*
Ankara	Bala*
Ankara	Polatlı*
Ankara	Elmadağ*
Afyon	Sandıklı*
Aksara	Merkez*
Balikesir	Bandırma*
Balikesir	İvrindi*
Balikesir	Merkez*
Bursa	Gemlik*
Erzurum	Tekman*
Erzurum	**Çat***
Erzincan	Tercan*
Isparta	Uluborlu*
Karabük	Eflani*
Giresun	Yağlıdere*
Rize	Çamlıhemşin*
Tokat	Zile*
Tokat	Başçiftlik*
Tokat	**Erbaa***
Usak	Merkez*
Usak	Eşme*
Aydin	Köşk*
Çorum	Kargı*
Erzincan	Merkez*
Eskisehir	Beylikova*
Eskisehir	Seyitgazi*
Kütahya	Tavşanlı*
Bursa	Orhangazi*
Bursa	Orhaneli*
Çanakkale	Lapseki*
Agri	Doğubeyazıt*
Kütahya	Gediz*
Malatya	Yazıhan*
Tokat	Turhal*
Amasya	Taşova*
Amasya	**Merzifon***
Burdur	Bucak*
Denizli	Bekilli*
Denizli	Honaz*
Elazığ	Palu*
Kastamonu	Merkez*
Samsun	Çarşamba*
Samsun	**Tekkeköy***
Sivas	Yıldızeli*
Gaziantep	**Nurdağı***
Kirsehir	**Kaman***
Konya	**Güneysınır***
Konya	**Çumra***
Sinop	**Durağan***
Trabzon	**Şalpazarı***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik, dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, nga ndarjet administrative të shtetit të Turqisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.3:

2.1. Për kafshët e llojit të dhirta dhe të leshta certifikata veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose të dhive në ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja, ose për 21 ditët e fundit, në një stabiliment ku nuk është raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve ose i dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti nuk ka qenë i vendosur në një zonë të infektuar me linë e dhenve ose të dhive; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine për 21 ditë para dërgesës;

d) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe të dhive; ose

e) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor, jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 4 muaj përpara dërgesës (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virusi i gjallë, i çaktivizuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshirë në vaksinë duhet të shënohen në certifikatë).

2.2. Për spermën e cjepve dhe të deshve, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se kafshët dhuruese:

a) nuk shfaqin asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose të dhive në ditën e mbledhjes së spermës dhe për 21 ditët në vijim;

b) janë mbajtur në vendin eksportues për 21 ditë para grumbullimit, në një stabiliment ose qendër fekondimi artificial, ku nuk janë raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve dhe të dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti ose qendra e

mbarështimit artificial nuk është e vendosur në zonën e infektuar të lisë së dhenve dhe të dhive;

c) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe të dhive; ose

d) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virus i gjallë i inaktivuar, apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshira në vaksinë do të tregohen, gjithashtu, në certifikatë).

2.3. Për lëkurën dhe leshin e kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se këto produkte:

a) vijnë nga kafshë që nuk janë mbajtur në zonën e infektuar me linë e dhenve dhe të dhive; ose

b) janë përpunuar për të garantuar asgjësimin e virusit të lisë së dhenve dhe të dhive, në ambiente të kontrolluara dhe të miratuara nga Autoriteti Veterinar i vendit eksportues.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, nënprodukteve të tyre dhe materialit biologjik.

4. Urdhri nr. 981, datë 19.11.2024, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe të dhive të shfaqur në shtetin e Turqisë", shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 1, datë 6.1.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës "d", të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore"; të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin Publik", të ndryshuar; të pikës 2, të nenit 73, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, znj. Ledina Beqiraj Agalliu, me detyrë sekretar i përgjithshëm pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

2. Kompetencat e deleguara të Titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit do të ushtrohen për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në datën 31 dhjetor 2025.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri sekretari i përgjithshëm.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

URDHËR
Nr. 2, datë 6.1.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr.

90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, z.Endrit Musaj, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Trajnimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore, për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.

2. Kompetencat e deleguara të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri më datë 31 dhjetor 2025.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet z.Endrit Musaj, drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Trajnimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

URDHËR
Nr. 2, datë 6.1.2025

PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË TË EGËR, NË MJEDISET E HAPURA DHE NË TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës; të shkronjës "b", të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Ndalimin e shitjes dhe tregtimit të shpendëve të gjallë në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla në territorin e:
- Njësisë Administrative Vlorë;
- Njësisë Administrative Qendër;
- Njësisë Administrative Shushicë;
- Njësisë Administrative Orikum;
- Njësisë Administrative Kotë.

2. Ndalimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë nga ferma në fermë dhe nga ferma në tregjet e kafshëve të gjalla në territorin e:
- Njësisë Administrative Vlorë;
- Njësisë Administrative Qendër;
- Njësisë Administrative Shushicë;
- Njësisë Administrative Orikum;
- Njësisë Administrative Kotë.

3. Lejimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë sipas tabelës 4, të shtojcës 5, të urdhrit nr. 177, datë 28.3.2023, "Për miratimin e Programit Kombëtar të Mbikëqyrjes së Influencës Aviare", vetëm me autorizim të veterinerit zyrtar për në thertore, pasi është kryer testi i PCR-së dhe shpendët kanë rezultuar negativ ndaj sëmundjes së influencës aviare dhe të jenë shoqëruar me certifikatën shëndetësore të lëvizjes së shpendëve, në territorin e:
- Njësisë Administrative Vlorë;
- Njësisë Administrative Qendër;
- Njësisë Administrative Shushicë;
- Njësisë Administrative Orikum;
- Njësisë Administrative Kotë.

4. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të shpendëve të egër, veçanërisht ato të ujit, si dhe monitorimin e mëtejshëm për zogj të ngordhur ose të sëmurë në territorin e:
- Njësisë Administrative Vlorë;
- Njësisë Administrative Qendër;
- Njësisë Administrative Shushicë;
- Njësisë Administrative Orikum;
- Njësisë Administrative Kotë.

5. Ky urdhër zbatohet në përputhje me:
- Urdhrin nr. 117, datë 19.3.2022, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë";
- Urdhrin nr. 411, datë 20.9.2022, "Për miratimin e Planit të Kontigjencës për sëmundjen e influencës aviare";
- Urdhrin nr. 177, datë 28.3.2023, "Për miratimin e Programit Kombëtar të Mbikëqyrjes së Influencës Aviare";
- Urdhrin nr. 235, datë 27.7.2009, "Për miratimin e rregullores 'Mbi masat e biosigurisë

ndaj gripit të shpendëve të shkaktuar nga nëntipi H5N1, në zogjtë e egër, në shpendët, pulat e stabilimenteve të shpendarisë"';

- Urdhrin nr. 236, datë 27.7.2009, "Për miratimin e rregullores 'Mbi disa masa mbi mbrojtjen ndaj gripit të pulave, shkaktuar nga nëntipi H5N1 te zogjtë e egër"'.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 4, datë 7.1.2025

PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË, NË MJEDISET E HAPURA DHE NË TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës; të shkronjës "b", të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e shitjes dhe tregtimit të shpendëve të gjallë në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla në territorin e:
- Njësisë Administrative Paskuqan;
- Njësisë Administrative Dajt;
- Njësive Administrative të Qytetit Tiranë;
- Njësisë Administrative Farkë;
- Njësisë Administrative Bërxull;
- Njësisë Administrative Vaqar;
- Njësisë Administrative Kashar;
- Njësisë Administrative Kamzë;
- Njësisë Administrative Zall-Herr;
- Njësisë Administrative Zall-Bastar.

2. Ndalimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë nga ferma në fermë dhe nga ferma në tregjet e kafshëve të gjalla në territorin e:
- Njësisë Administrative Paskuqan;
- Njësisë Administrative Dajt;
- Njësive Administrative të Qytetit Tiranë;
- Njësisë Administrative Farkë;
- Njësisë Administrative Bërxull;
- Njësisë Administrative Vaqar;
- Njësisë Administrative Kashar;
- Njësisë Administrative Kamzë;
- Njësisë Administrative Zall-Herr;
- Njësisë Administrative Zall-Bastar.

3. Lejimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë sipas tabelës 4, të shtojcës 5, të urdhrit nr. 177, datë 28.3.2023, "Për miratimin e Programit Kombëtar të Mbikëqyrjes së Influencës Aviare", vetëm me autorizim të veterinerit zyrtar për në thertore, pasi është kryer testi i PCR-së dhe shpendët kanë rezultuar negativ ndaj sëmundjes së influencës aviare dhe të jenë shoqëruar me certifikatën shëndetësore të lëvizjes së shpendëve, në territorin e:
- Njësisë Administrative Paskuqan;
- Njësisë Administrative Dajt;
- Njësive Administrative të Qytetit Tiranë;
- Njësisë Administrative Farkë;
- Njësisë Administrative Bërxull;
- Njësisë Administrative Vaqar;
- Njësisë Administrative Kashar;
- Njësisë Administrative Kamzë;
- Njësisë Administrative Zall-Herr;
- Njësisë Administrative Zall-Bastar.

4. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të shpendëve të egër, veçanërisht ato të ujit, si dhe monitorimin e mëtejshëm për zogj të ngordhur ose të sëmurë në territorin e:
- Njësisë Administrative Paskuqan;
- Njësisë Administrative Dajt;
- Njësive Administrative të Qytetit Tiranë;
- Njësisë Administrative Farkë;
- Njësisë Administrative Bërxull;
- Njësisë Administrative Vaqar;
- Njësisë Administrative Kashar;
- Njësisë Administrative Kamzë;
- Njësisë Administrative Zall-Herr;
- Njësisë Administrative Zall-Bastar.

5. Ky urdhër zbatohet në përputhje me:

- Urdhrin nr. 117, datë 19.3.2022, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë";

- Urdhrin nr. 411, datë 20.9.2022, "Për miratimin e Planit të Kontigjencës për Sëmundjen e Influencës Aviare";

- Urdhrin nr. 177, datë 28.3.2023, "Për miratimin e Programit Kombëtar të Mbikëqyrjes së Influencës Aviare";

- Urdhrin nr. 235, datë 27.7.2009, "Për miratimin e rregullores 'Mbi masat e biosigurisë ndaj Gripit të Shpendëve të shkaktuar nga nëntipi H5N1, në zogjtë e egër, në shpendët, pulat e stabilimenteve të shpendarisë'".

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

VENDIM
Nr. 276, datë 13.12.2024

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "M.C ENERGJI GOJAN" SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "GOJAN"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", 38 pika 1, germa "a", dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015; të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", pika 2, 13 dhe 14, pika 9, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1845/22 prot., datë 11.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'M.C. Energji Gojan" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Gojan",

konstatoi se:

- Shoqëria "M.C. Energji Gojan" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1845 prot., datë 30.8.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Gojan", në pellgun ujëmbledhës të lumit "Fani i Madh," në zonën e Gojan–Gjegjanit, qrku Shkodër, me kapacitet të instaluar 15 mw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 202, datë 27.9.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.10.2024 dhe 2.10.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 30.10.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 2057 prot., datë 8.10.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, ndërsa me shkresën nr. 1845/7 prot., datë 4.10.2024 i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo të plotësuar pjesërisht.

- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, rezulton se shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1845/8 prot., datë 16.10.2024, nr. 1845/12 prot., datë 12.11.2024, nr. 1845/13 prot., datë 18.11.2024 dhe nr. 1845/16 prot., datë 27.11.2024.

- Me qëllim shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar dhe/ose zhvillimin e një korrespondence të mundshme me shoqërinë, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 259, datë 2.12.2024 u vendos zgjatja deri në 10 (dhjetë) ditë pune e

vendimmarrjes së Bordit, në lidhje me aplikimin e shoqërisë "M.C. Energji Gojan" sh.p.k.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1845/17 prot., datë 4.12.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se mbetej ende informacion e dokumentacion i paplotësuar, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me *email*-in e protokolluar me nr. 1845/20 prot., datë 10.12.2024, për ta informuar për sa konstatuar prej saj. Në përgjigje me email-in e protokolluar me nr. 1845/21 prot., datë 10.12.2024, shoqëria ka përcjellë informacion dhe dokumentacion plotësues për këtë aplikim.

- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat: "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat: "a", "b", "c" dhe "d"; për pikën 1.3, germën "b" dhe "c"; si dhe për pikën 2.1, germat: "a", "b", "c", "d", "e" dhe "f".

- Rezulton se shoqëria "M.C. Energji Gojan" sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Kontratën e Koncesionit të formës BOT me nr. 2515 rep., nr. 1181 kol., datë 6.11.2017, "Kontratë koncesioni e formës 'BOT' (ndërtim-operim-transferim) për objektin "Dhënie me koncesion të hidrocentralit Gojan", të ndryshuar me kontratën shtesë të koncesionit nr. 2 rep., nr.2/3 kol., datë 3.1.2019 dhe me kontratën shtesë nr. 1990 rep., nr. 1465 kol., datë 7.12.2022;

- Është pajisur me lejen e përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor nr. 1/2 prot., datë 20.4.2021, dhënë nga Këshillit i Basenit Ujor Mat, me afat vlefshmërie sipas kontratës koncensionare;

- Është pajisur me vendim për VNM-në paraprake, lëshuar më 17.10.2022 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin "Ndërtim i HEC 'Gojan'", për fuqinë 15 mw. Shoqëria ka dokumentuar fillimi e punimeve në datën 18.1.2024, pra brenda afatit të vlefshmërisë së kësaj VNM-je.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa "a", të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Po ashtu, në nenin 5, pika 2 të rregullores së sipërcituar parashikohet se: "Për aplikimet në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të cilat paraqiten në ERE më vonë se data efektive e kontratës/autorizimit, llogaritja e afatit së licencimit, bëhet për periudhën e mbetur."

- Kontrata e koncesionit nr. 2515 rep., nr. 1181 kol., datë 6.11.2017, të ndryshuar, ka një afat 35-vjeçar dhe konstatohet se shoqëria ka humbur afërsisht 7 vjet e 1 muaj nga periudha koncensionare. Si e tillë periudha e mbetur për licencim është afërsisht 27 vjet e 11 muaj, afat ky i cili përfundon konkretisht më 6.11.2052, ndaj dhe licenca do të jetë e vlefshme deri në këtë datë.

- Në lidhje me vërtetimin që shoqëria nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, ajo ka depozituar në ERE dokumentin "Detyrimet në kohë reale", të datës 10.12.2024, i cili nuk ka nënshkrim dhe vulë të institucionit përkatës, por është i shoqëruar me një vërtetim noterial të njësisë me origjinalin. Vërtetimi që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të depozitohet nga shoqëria në vijim, në kuadër të zbatimit dhe mbikëqyrjes së kushteve të licencës përkatëse.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "M.C Energji Gojan" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Gojan", në pellgun ujëmbledhës të lumit "Fani i Madh,", në zonën e Gojan–Gjegjanit, qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 15 mw, deri më 6.11.2052.

2. Shoqëria duhet të vendosë në punë hidrocentralin brenda datës 28.11.2025.

3. Ky vendim është objekt rishikimi.

4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "M.C. Energji Gojan" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe

shoqërinë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 277, datë 13.12.2024

MBI SHTYRJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR MIRATIMIN E PLANIT DHJETËVJEÇAR TË INVESTIMEVE NGA SHOQËRIA "ALBGAZ" SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të pikës 12, të nenit 16, neneve 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; të pikës 3, të nenit 53, të ligjit nr. 44/2015, "Kodit i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2017/5 prot., datë 12.12.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror "Shtyrjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria 'Albgaz' sh.a.",

konstatoi se:

- ERE, me vendimin e Bordit nr. 293, datë 12.10.2023, "Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria 'Albgaz' sh.a.", ka vendosur nisjen e procedurës për shqyrtimin e "Planit të investimeve dhjetëvjeçar (2023–2032)" të paraqitur nga shoqëria "Albgaz" sh.a.

- Shoqëria është njoftuar për vendimin nr. 293/2023 me shkresën nr. 2152/5 prot., datë 23.10.2023, ndërsa vendimi është publikuar edhe në faqen zyrtare të ERE-s. Gjithashtu, vendimi është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 157, datë 30.10.2023.

- ERE, me shkresën nr. 2152/6 prot., datë 31.10.2023, i ka kërkuar shoqërisë "Albgaz" sh.a. të marrë në konsideratë parashtrimet, në përputhje me nenin 11, pika 3, të "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit nr. 18, datë 10.1.2018. Në përgjigje të kësaj kërkese, "Albgaz" sh.a., me shkresën nr. 15 prot., datë 16.1.2024, të protokolluar në ERE me shkresën nr. 153 prot., datë 16.1.2024, ka paraqitur një relacion argumentues mbi ecurinë e investimeve për projektet e klasifikuara si me rëndësi strategjike në sektorin e gazit natyror në Shqipëri.

- Për sa më sipër, u vendos organizimi i një seance teknike më datë 23.2.2024 ndërmjet përfaqësuesve të shoqërisë "Albgaz" sh.a. dhe drejtorive teknike të ERE-s, njoftuar me shkresën nr. 152/3 prot., datë 16.2.2024. Gjatë seancës, në zbatim të "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit nr. 18, datë 10.1.2018, shoqërisë "Albgaz" sh.a. iu kërkua të paraqesë:

1. Miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve (2023–2032) nga Këshilli Mbikëqyrës.
2. Detaje mbi mënyrën dhe burimet e financimit të investimeve.
3. Informacion mbi bashkëpunimin me KESH sh.a. për projektin e Tubacionit Fier–Vlorë, në përputhje me Gaz Masterplan-in.
4. Opinionin e Ministrisë së Financave mbi planin e investimeve.

- ERE, me shkresën nr. 2017 prot., datë 30.9.2024, i ka kërkuar "Albgaz" sh.a. të dorëzojë informacionin dhe dokumentacionin plotësues si më poshtë:

- Ecurinë e miratimit të planit dhjetëvjeçar të investimeve (2023–2032) nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë.

- Opinionin e Ministrisë së Financave (MF) mbi planin e investimeve, në përputhje me nenin 10, pika 3 të rregullores për procedurat e miratimit të planeve të investimeve.

- Detaje mbi mënyrën dhe burimet e financimit të investimeve të planifikuara.

- Informacion mbi bashkëpunimin me KESH sh.a. për projektin e Tubacionit Fier–Vlorë, sipas Gaz Masterplan-it.

- Studim fizibiliteti për projektet prioritare të planit të investimeve, në përputhje me nenin 8, pika 6, germa "e" të rregullores.

- Informacion mbi publikimin e planit dhjetëvjeçar dhe opinionet e palëve të interesuara, siç përcaktohet në nenin 6, germa "f" të rregullores.

- Në përgjigje të shkresës së ERE nr. 2017 prot., datë 30.9.2024, "Albgaz" sh.a. me shkresën nr. 103/1 datë 24.10.2024, protokolluar në ERE me nr. 2017/1 prot., datë 28.10.2024, ka informuar për masat e ndërmarra dhe ka kërkuar një shtyrje afati deri në mars 2025 për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar, duke theksuar rëndësinë e përgatitjes së informacionit të plotë dhe të saktë duke cituar edhe shkresën nr. 132 prot., datë 2.11.2023, drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë si organi më i lartë vendimmarrës, me kërkesën për t'iu drejtuar Ministrisë së Financave (MF) me një kërkesë zyrtare për dhënie opinioni në lidhje me planin dhjetëvjeçar të investimeve që shoqëria ka depozituar në ERE për shqyrtim dhe miratim, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Mbi këtë korrespondencë mbetet në pritje të një opinioni nga organet kompetente.

- ERE me shkresën nr.2017/3 prot., datë 2.12.2024, kërkoi nga "Albgaz" sqarimin se në çfarë faze ndodhet me marrjen e miratimeve të nevojshme, në mënyrë që të vijohet me dorëzimin e të gjithë dokumentacionit konform "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror" miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 18, datë 10.1.2018.

- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, shoqëria "Albgaz" sh.a. me shkresën me nr.103/3 prot., datë 10.12.2024, protokolluar në ERE me nr. 2017/4 prot., datë 2.12.2024, paraqiti kërkesën për shtyrjen e afatit deri në muajin dhjetor të vitit 2025, për përmbushjen e detyrave të kërkuara nga ERE, duke shprehur angazhimin në përditësimin e planit të investimit nga prej saj dhe plotësimin e të gjitha detyrimeve.

- Në pikën 3, të nenit 53, të ligjit nr. 44/2015, "Kodit i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" parashikohet se: "Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit."

- Për gjithë sa më sipër, duke qenë se marrja e vendimeve/qëndrimeve të organeve kompetente si më sipër, është parakusht për marrjen e një vendimi përfundimtar nga ERE, vlerësohet që të merret parasysh kërkesa për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit mbi kërkesën e shoqërisë "Albgaz" sh.a. për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve deri në dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar dhe përgatitjen e një informacioni të plotë e të saktë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria "Albgaz" sh.a., deri në muajin dhjetor të vitit 2025.

2. Drejtoria e Gazit Natyror, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË
Nr. 56, datë 8.1.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Eliminimi i pikave të zeza (*Black Spots*) në rrjetin rrugor kombëtar Shkodër–Hani i Hotit, kryqëzimi rruga e Hurmave", me vlerë totale paraprake të shpronësimin 44,010 (dyzet e katër mijë e dhjetë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për pasurinë e llojit "arë", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 44, 010 (dyzet e katër mijë e dhjetë) lekë.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ELIMINIMI I PIKAVE TË ZEZA (*BLACK SPOTS*) NË RRJETIN RRUGOR KOMBËTAR SHKODËR–HANI I HOTIT, KRYQËZIMI RRUGA E HURMAVE"

Nr.	Pronari										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM							SHËNIME (D+E) (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
											"Arë"			"Truall"			Vlera Totale (lekë)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	"Arë" (m²)	"Truall" (m²)	"Ndërtesë" (m²)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1	Shuaip	Smail	Haxhia	3428	29/1	arë	8000				128	270	34560				34560	
2	Smail	Ali	Haxhia	3429	101/16	arë	8175				35	270	9450				9450	
	SHUMA PARAPRAKE																**44010**	

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 288 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/01/13 15:32:41 +02'00'
d6c7ce9bfad14be0876aa7f0f3987c7c2025011315322968031

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)